



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
\_\_\_\_\_.2021

Tiranë, më

**VENDIM**  
**Nr. 515, datë 03.11.2021**

**PËR**  
**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM**  
**GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016 GJATË USHTRIMIT**  
**TË DETYRËS SË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 68, 89 e vijues dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 194, datë 12.05.2021 “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë” dhe nr. 193, datë 12.05.2021, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

# PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

---

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM  
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E  
GJYQTARES  
{...}

---

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E  
VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR  
ÇDO KRITER VLERËSIMI**

---

**1. AFTËSITË PROFESIONALE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e ndihmësmagjistratit në drejtim të njohurive dhe arsytimit ligjor, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së ndihmësmagjistratit, bazuar në dokumentet ligjore të dorëzuara prej tij, relacionet/opinionet ligjore të përgatitur prej tij për çështjet e përzgjedhura me short dhe burimet e tjera të vlerësimit. Aftësia profesionale e ndihmësmagjistratit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.*

**1.A. NJOHURITË LIGJORE**

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: "Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara, katër relacione, konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën penale duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ajo ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu njeh edhe parimet e përgjithshme të së drejtës të procesit të rregullt ligjor, megjithëse rrallë i zbaton ato në praktikë (shih dokumentin 3). Në asnjë rast, në funksion të zbatimit të ligjit nuk ka përdorur referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, por vetëm në dy raste ka përdorur referenca në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentin 1 dhe dosjen 1). Në 4 relacionet dhe 4 dosjet gjyqësore të vëzhguara, është konstatuar përgjithësisht se ajo identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara, është konstatuar se vendimi gjyqësor apo relacioni i

POLI I DREJTËSISË

RRUGA "ANA KOMNENA"

TIRANË

të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të konstadiktoriteti e gjer tek arsytimi i vendimit gjyqësor. Karakteristikë e opinioneve të hartuara nga ndihmësja ligjore është pasqyrimi i detajuar i rrethanave të çështjes, pretendimet e parashtruara para Gjykatës së Lartë si dhe analizën e çështjes në të cilën evidentohen pretendimet e ngritura nga rekursuesi, të cilat analizohen në frymën e gjyqimit në nivel të lartë, bazuar në normat kushtetuese dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese. Në dokumentet ligjore nuk evidentohet përdorimi i parimeve të përgjithshme të së drejtës, por analizë dhe referim në jurisprudencën përkatëse në rastet e relatuar. Nga ana tjetër në 2 dokumentet e përzgjedhura dhe 2 dosjet gjyqësore të vëzhguara, janë ankimuar. Në 2 raste Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit (shih dosjet 1 dhe 2) ndërsa në dy rastet e tjera ende nuk janë shqyrtuar ankimet nga Gjykata e Apelit Shkodër (shih dokumentet 2 dhe 3). Në 4 rastet e tjera dokumentet ligjore janë relacione të ndihmësit ligjor (shih dokumentin 1 dhe dosjet 3,4 dhe 5). Vlen të evidentohet se nga relacioni dokument ligjor i paraqitur prej saj dhe 3 relacionet e shortuara si ndihmëse ligjore, nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre dhe as nënshkrimi i ndihmësit ligjor (shih dokumentin 1 dhe dosjet 3,4 dhe 5). ...”.

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me aspektin e njohurive ligjore, konkludohet se : “E aftë për të shkruar thjesht dhe qartë projekt vendimet gjyqësore, që rezultojnë të kuptueshme nga të gjithë.<sup>1</sup>”

## **1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

- *Në lidhje me përcaktimin dhe renditjen e rrethanave të çështjes:*

Në 9 dokumentet ligjore burim vlerësimi<sup>2</sup> faktet e çështjes janë renditur në pjesën hyrëse të relacionit, nën titullin “Rrethanat e çështjes”, duke u pashkruar në mënyrë të plotë, të qartë dhe koncize. Paraqitja e rrethanave të faktit ndërthuret në mënyrë logjike me provat e administruara në dosje, mbi bazën e së cilave fakti penal është ndërtuar. Rezulton e dukshme aftësia e ndihmësmagjistrates për ti përmbledhur dhe parashtruar faktet e çështjes në mënyrë të thjeshtë dhe lehtësisht të kuptueshme, duke evidentuar elementet thelbësore që lidhen me veprën penale, elementë të anës objektive dhe subjektive të saj, autorësinë e të pandehurit/ve dhe rolin e secilit (në çështjet e themelit), elementë që lidhen me kohën e dënimit të vuajtur, kushtet faktike që lidhen me kriteret ligjore të lirimit para kohe me kusht (në çështjet që lidhen me kërkesat penale), pa u ndaluar në elementë periferikë të faktit objekt trajtimi. Në raste specifike, kur

<sup>1</sup> Ky vlerësim lidhur me aftësitë profesionale juridike dhe teknike, në treguesin “Qartësia de të shkruarit të vendimit”, është i njëjtë në të gjitha aktet e vlerësimit nga Kolegji Penal.

<sup>2</sup> Relacioni që i përket çështjes penale me nr. 57010-00719-00-2010, me të pandehur I.A, R.C, B.A etj., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 184/2 dhe 300 i Kodit Penal, referuar kopjes së relacionit të ndodhur në dosjen gjyqësore, rezulton të jetë përgatitur nga ndihmësi ligjor Ferdinand Caka, për pasojë nuk mund të konsiderohet burim vlerësimi për gjyqtaren {...}.

mënyra e marrjes së provës dhe përmbajtja e saj, përbëjnë shkak thelbësor për çështjen objekt shqyrtimi, provat dhe mënyra e marrjes së tyre, pasqyrohen dhe analizohen në mënyrë më të zgjeruar dhe analitike<sup>3</sup>.

- *Në lidhje me evidentimin e ecurisë procedurale të çështjes:*

Në drejtim të renditjes së ecurisë procedurale të çështjes, në të gjitha dokumentet ligjore burim vlerësimi, menjëherë pas paraqitjes në mënyrë të përmbledhur dhe koncize të fakteve thelbësore të çështjes, rezulton të jetë evidentuar dhe pasqyruar në mënyrë të qartë qëndrimi i gjykatave të faktit duke pasqyruar dispozitivin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, të apelit dhe/ose të Gjykatës së Lartë në rastet kur çështja është shqyrtuar më parë dhe në këtë shkallë, dhe në mënyrë të përmbledhur thelbi i arsytimit të secilës gjykatë.

Ndihmësmagjistratja evidenton në çdo rast qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Shkallës së Parë duke pasqyruar në fillim dispozitivin e vendimit. Pas këtij momenti paraqitet në një ose disa paragrafë, në mënyrë të përmbledhur, pjesa thelbësore e arsytimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me çështjen, duke i kushtuar rëndësi pasqyrimin të atyre pjesëve të arsytimit që lidhen drejtpërdrejtë me elementët e veprës penale, provueshmërinë e tyre dhe të autorësisë së veprës, kushtet dhe kriteret për caktimin dhe individualizimin e dënimit në rastet kur ai ka përbërë shkak rekursi, analizën e provave të administruar për efekt të vlerësimit të kriterëve ligjore të aplikimit të lirimimit para kohë me kusht apo analizën e fakteve në lidhje me shkaqet e rishikimit të vendimit.

Më pas pasqyrohet dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit, duke vijuar me tej me pasqyrimin e pjesëve thelbësore të arsytimit, veçanërisht në rastet kur qëndrimi i Gjykatës së Apelit ndryshon nga ai i gjykatës së shkallës së parë<sup>4</sup>. Në rastet kur qëndrimi i gjykatës së apelit është i njëjtë me atë të shkallës së parë, ndihmësmagjistratja ka paraqitur pjesët kryesore të arsytimit të vendimit të gjykatës, duke evidentuar kryesisht ato pjesë të arsytimit që lidhen me shkaqet e apelit<sup>5</sup> dhe në ndonjë rast, duke evidentuar vetëm dispozitivin e vendimit të Gjykatës së Apelit pa ri sjellë pjesë të arsytimit të tij<sup>6</sup>. Në shumicën e rastet kur qëndrimi i të dy gjykatave është i njëjtë, rezulton kujdesi për të pasqyruar qëndrimin e gjykatës së apelit në lidhje me pretendime të cilat janë ngritur për vlerësim para saj, sikurse është rasti i pasqyrimin të qëndrimin të gjykatës së apelit në lidhje me kriteret e caktimit të llojit dhe masës së dënimit<sup>7</sup>, apo ekzistencën dhe provueshmërinë e kushteve ligjore për aplikimin e lirimimit me kusht<sup>8</sup>.

***Në tërësi***, sa i përket pasqyrimin të ecurisë procedurale të çështjeve, si një element thelbësor për ta bërë të kuptueshëm por edhe të qartë natyrën e çështjes së shtuar për zgjidhje para Kolegjit përkatës, rezulton kujdesi i ndihmësmagjistrates për të pasqyruar qartë dhe me saktësi ecurinë

<sup>3</sup> *Relacion për çështjen penale me nr. 52104-00391-00-2012 me të pandehuri E.Kotorri.*

<sup>4</sup> *Relacion për çështjen penale 53101-00394-00-2014 me të pandehur D.Xhangolli dhe E.Metaliaj, relacion për çështjen penale me nr. 52102-00418-00-2011 me të pandehur K.Balla, relacion për çështjen penale me nr. 56180-01434-00-2013 me të pandehuri S.Likaj dhe M.Ivziku.*

<sup>5</sup> *Relacion për çështjen penale nr. 52111-00875-00-2011 me të pandehur S.Ndoj.*

<sup>6</sup> *Relacion për çështjen penale nr. 56430-00489-00-2014 me të pandehur M.Hala.*

<sup>7</sup> *Relacion për çështjen penale me nr. 53101-01334-00-2013 me të pandehur A.Hudhra dhe S.Brasha.*

<sup>8</sup> *Relacion për çështjen penale me nr. 86000-00402-00-2014 me kërkues T.Zeqo dhe relacion për çështjen penale me nr. 86000-0043-00-2014 me kërkues E.Belulaj.*

procedurale të çështjeve, posaçërisht në ato raste kur çështja vjen para Gjykatës së Lartë si pasojë e një procesi rishikues<sup>9</sup>.

- ***Në lidhje me shkaqet e rekursit/kërkesës drejtuar Gjykatës së Lartë:***

Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, shkaqet e rekursit/kërkesës drejtuar Gjykatës së Lartë, paraqiten në një pjesë me vete të relacionit të titulluar sipas rastit “rekursi” ose “kërkesa për rishikim dhe shkaqet”, menjëherë pas paraqitjes së ecurisë procedurale të çështjes dhe qëndrimit të gjykatave të faktit.

Në pasqyrimin e shkaqeve, pas evidentimit të palës që ka ushtruar të drejtën e rekursit/kërkesën për rishikim dhe ka investuar Gjykatën e Lartë, ndihmësmagjistratja paraqet në mënyrë koncize dhe të përmbledhur shkaqet e bëra prezent nga pala që ka bërë rekurs ose ka paraqitur kërkesë për rishikim vendimi<sup>10</sup>. Shkaqet e rekursit në secilin dokument të vëzhguar, renditen në mënyrë të qartë dhe koncize, duke evidentuar edhe thelbin e argumenteve ligjore mbi të cilat pala ka mbështetur pretendimet e saj, duke qartësuar në këtë mënyrë edhe çështjet e zbatimit të ligjit procedural dhe material për të cilat pala i është drejtuar Gjykatës së Lartë. Në disa raste të cilat kanë karakter kompleks, shkaqet e kërkesës për rishikim vendimi paraqiten duke risjellë edhe dispozitat ligjore të referuara nga pala si dhe analizën e palës në lidhje me ligjshmërinë e marrjes së provave<sup>11</sup>.

- ***Në lidhje me identifikimin e natyrës së mosmarrëveshjes:***

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti dhe rrethanat e çështjes të përshkruara në pjesën hyrëse të relacionit, pavarësisht se nuk rezulton të jetë përcaktuar në mënyrë deklarative nga ndihmësmagjistratja në rekursin e analizuara. Identifikimi dhe përshkrimi i qartë dhe konciz i fakteve të çështjes si dhe ecuria procedurale të gjykimit, sjell si pasojë identifikimin e saktë të çështjes dhe përcakton natyrën specifike të çështjes sipas objektit të saj (çështje penale themeli, kërkesë gjatë fazës së ekzekutimit, kërkesë për rishikim vendimi).

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm dhe konfliktit të normave:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës/Kolegjit për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar dokumenteve ligjore burim vlerësimi, rezulton se ndihmësmagjistratja në shumicën e rasteve ka identifikuar dhe referuar ligjin e zbatueshëm, në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor, ndërsa në një prej tyre, në mendimin e ndihmësit ligjor nuk rezulton të jenë referuar dispozita të ligjit procedural ose material në mbështetje të arsytimit<sup>12</sup>.

Konkretisht, në 7 nga 9 dokumentet ligjore burim vlerësimi, në pjesën e pasqyrimin të mendimit të ndihmësit ligjor, rezulton të jenë referuar dispozita të ligjit procedural si më poshtë:

<sup>9</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 52104-00391-00-2012 me të pandehur E.Kotorri.

<sup>10</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 52104-00391-00-2012 me të pandehur E.Kotorri.

<sup>11</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 52104-00391-00-2012 me të pandehur E.Kotorri.

<sup>12</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 53101-00394-00-2014 me të pandehur D.Xhangolli dhe E.Metaliaj.

- neni 432 i K.Pr.P lidhur me konkluzionin se rekursi përmban<sup>13</sup> ose nuk përmban shkaqe ligjore<sup>14</sup>;
- neni 450 i K. Pr.P lidhur me konkluzionin se kërkesa për rishikim përmban shkaqe ligjore<sup>15</sup>.

Sa i përket identifikimit të ligjit material, në 5 nga 8 dokumentet ligjore burim vlerësimi, në pjesën e pasqyrimin të mendimit të ndihmësit ligjor, rezulton të jenë identifikuar dispozita të ligjit material të zbatueshëm, si më poshtë:

- neni 64 i Kodit Penal lidhur me kriteret ligjore të përgjithshme dhe të veçanta të aplikimit të lirimit para kohe me kusht<sup>16</sup>;
- nenet 76, 22 dhe 88/1 të Kodit Penal, lidhur me elementët e veprave penale të vrasjes me dashje të mbetur në tentativë dhe plagosjes së rëndë me dashje<sup>17</sup>;
- nenet 278/2 dhe 279 të Kodit Penal, si pjesë e konkluzionit se rekursi nuk përmban shkaqe ligjore pasi pretendimet e ngritura në të lidhen me këto dy vepra për të cilat gjykata e apelit ka konkluduar për fajësinë e të pandehurve<sup>18</sup>;
- neni 31/6 i ligjit nr. 10024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, lidhur me të dhënat e administruara në rastet e trajtimit të kërkesave për lirim para kohe me kusht<sup>19</sup>;
- neni 323 i Kodit Penal në lidhje me veprën penale të largimit të të burgosurit nga vendi i qëndrimit, në funksion të çështjes së ngritur për diskutim lidhur me ekzistencën e veprës penale<sup>20</sup>;

**Sa i përket evidentimit të konfliktit të normave**, në një nga dokumentet ligjore të analizuara rezulton të jetë evidentuar dhe vendosur përballë njëra tjetrës si pjesë e arsytimit të mendimit të ndihmësit ligjor, parashikimet e neneve 76 në lidhje me nenin 22 dhe 88/1 të Kodit Penal, duke bërë dallimin mes elementëve të anës subjektive, posaçërisht të qëllimit, të dy veprave penale si më sipër<sup>21</sup>.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për këtë tregues, vlerësohet edhe aftësia e ndihmësmagjistratit për t’i parashtruar verbalisht çështjet e mësipërme, kur i kërkohet nga gjyqtari relator. Në lidhje me aftësitë verbale të relatimit sa i përket identifikimit të natyrës së çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, pavarësisht se nuk rezultojnë të dhëna të drejtpërdrejta për këtë aspekt, në vlerësimet e Kolegjit Penal për aftësitë profesionale të ndihmësit ligjor jepet vlerësimi maksimal.

Dokumentat ligjore që analizohen e përbëjnë burim vlerësimi për ndihmësmagjistratin në Gjykatën e Lartë, për efekt të kriterit të aftësisë profesionale sipas Metodologjisë së miratuar përfshijnë analiza, opinione, materiale studimore etj

<sup>13</sup> Relacion për çështjen me nr. 52102-00418-00-2011 me të pandehur K.Balla.

<sup>14</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 53101-01334-00-2013 me të pandehuri A.Hudhra dhe S.Brasha; relacion për çështjen penale me nr. 86000-00402-00-2014 me kërkues T.Zeqo; relacion për çështjen penale nr. 76000-00043-00-2014 me kërkues E.Belulaj, relacion i çështjes penale me nr. 56430-00489-00-2014 me të pandehur M. Hala; relacion i çështjes penale nr. 56180-01434-00-2013 me të pandehur S.Likaj dhe M. Ivziku;

<sup>15</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 52104-00391-00-2012 në çështjen e kërkuesit E.Kotorri.

<sup>16</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 86000-00402-00-2014 me kërkues T.Zeqo; relacion për çështjen penale nr. 76000-00043-00-2014 me kërkues E.Belulaj.

<sup>17</sup> Relacion për çështjen me nr. 52102-00418-00-2011 me të pandehur K.Balla.

<sup>18</sup> Relacion i çështjes penale nr. 56180-01434-00-2013 me të pandehur S.Likaj dhe M. Ivziku;

<sup>19</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 86000-00402-00-2014 me kërkues T.Zeqo; relacion për çështjen penale nr. 76000-00043-00-2014 me kërkues E.Belulaj.

<sup>20</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 52111-00875-00-2011 me të pandehur S.Ndoj.

<sup>21</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 52102-00418-00-2011, me të pandehur K.Balla.

Në katër vendimet gjyqësore civile burim vlerësimi<sup>22</sup>, sa i përket treguesit “*Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave*”, rezulton se: Provat e paraqitura nga palët nuk parashtrohen të ndara në vendim, por janë të integruara dhe të analizuar në mënyrë të plotë, në mbështetje të rrethanave të faktit. Elementë të këtyre të fundit, gjenden të pasqyruar dhe në pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të pasqyruara në mënyrë të ndarë e të dallueshme për secilën prej tyre si dhe janë pjesë e arsytimit të gjyqtarës lidhur me këto pretendime. Karakteristikë e gjyqtarës është paraqitja e rrethanave të faktit si pjesë integrale e pjesës arsyetuese të vendimit, duke paraqitur një analizë të detajuar dhe të plotë të provave mbi të cilat mbështeten rrethanat e faktit, sikurse ato kanë rezultuar të provuara në gjykim. Vetëm në një rast<sup>23</sup> rrethanat e faktit paraqiten në një pjesë të ndarë të vendimit gjyqësor, në mënyrë të përmbledhur, por sërish faktet integrohen në mënyrë organike në arsytimin e gjyqtarës lidhur me mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Në paraqitjen e fakteve gjyqtarja është e qartë dhe ezauruese duke integruar dhe analizuar në mënyrë të plotë provat e administruara mbi të cilat është konkluduar për provueshmërinë e fakteve të çështjes.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në katër vendimet gjyqësore të analizuar, gjyqtarja përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së fakteve të çështjes, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe referimit në dispozitat ligjore. Përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet në mënyrë të qartë dhe të shprehur, bazuar në identifikimin e shkakut ligjor të padisë (*mosmarrëveshje kontraktore, kërkesë padi për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues pa titull, padi njohje pavërtetësi dokumenti dhe njohjen e marrëdhënies së punës apo padi me shkak ligjor nenin 609 të K.Pr.Civile sa i përket pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv*). Përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet duke evidentuar qartë mënyrën e fitimit të pronësisë së pretenduar, veprimin juridik ose titullin ekzekutiv, si pasojë e të cilit pala paditëse ka ngritur pretendimet objekt padie duke kërkuar sipas rastit, pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, përmbushjen e detyrimit kontraktor dhe shpërblimin e dëmit, fitimin e pronësisë me parashkrim fitues pa titull apo njohjen e pavërtetësisë së dokumentit. Kjo analizë i shërben prezantimit të qartë të natyrës së konfliktit si dhe orienton arsytimin ligjor në vijim.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në katër vendimet e vëzhguara, rezulton se pas pasqyrimin të fakteve të çështjeve dhe pretendimeve të palëve në gjykim, gjyqtarja referon dhe/ose citon dispozitat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe dispozita të ligjeve posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Konkretisht, në 4 vendimet e analizuar, identifikohen, referohen dhe/ose citohen dispozitat ligjore si më poshtë :

- nenet 36/1, 41, 610, 43/2, 45/1 të K.Pr.Civile, lidhur me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, sipas objektit të saj;
- nenin 192 të K.Pr.C lidhur me vlerësimin për rrëzimin e kërkesës së palës paditëse për thirrjen e personit të tretë<sup>24</sup>;
- nenin 32 pika b) dhe c) të K.Pr.Civile lidhur me vlerësimin për legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve ndërgjyqëse dhe përcaktimin e natyrës së çështjes objekt gjykimi<sup>25</sup>;

<sup>22</sup> Vendimi me nr. 849/2847, datë 23.06.2016, vendimi nr. 1115/4093, datë 28.09.2016, vendimi nr. 686/2229, datë 24.05.2016 dhe vendimi nr. 692/2247, datë 25.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

<sup>23</sup> Vendim nr. 849/2847, datë 23.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

<sup>24</sup> Vendim nr. 686/2229, datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

<sup>25</sup> Vendim nr. 692/2247, datë 25.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.



- neni 609 i Kodit të Procedurës Civile lidhur me shkaqet e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv dhe neni 608 të Kodit Civil lidhur me kushtet për lindjen e përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit<sup>26</sup>;
- nenet 717 dhe 722 të Kodit Civil lidhur me afatin për kundërshtimin e të metave të sendit si dhe të drejtat e blerësit në rastin e konstatimit të të metave të sendit dhe nenet 659, 660, 663, 698, 705-756, 710,711,715 të Kodit Civil lidhur me kuptimin e marrëdhënies kontraktore, detyrimet e palëve dhe pasojat e mospërmbushjes së tyre<sup>27</sup>;
- neni 169 të Kodit Civil lidhur me institutin e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues pa titull dhe kriteret ligjore që duhet të përmbushen për fitimin e pronësisë me këtë mënyrë origjinale të fitimit të pronësisë<sup>28</sup>;

Gjyqtarja identifikon dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve, si më poshtë:

- ligji nr. 8743, datë 22.02.2002 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”<sup>29</sup>;
- neni 36 i ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, lidhur me përcaktimin e mënyrës së përpilimit të faturave tatimore<sup>30</sup>;

## KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë, konciz, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes, paraqitjen e tyre në mënyrë të integruar me provat e administruara, pasqyrimin e ecurisë procedurale të çështjes në gjykatat e faktit, duke integruar në këtë pjesë të relacioneve pjesët thelbësore të arsytimit të këtyre gjykatave, posaçërisht në rastet kur disponimi i gjykatave të faktit është i ndryshëm. Sa i përket identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në rastin konkret, në shumicën e akteve të analizuara referohet norma procedurale penale në lidhje me shkaqet e rekursit ose kërkesës për rishikim, ndërsa sa i përket ligjit material të zbatueshëm, ai identifikohet vetëm në një pjesë të dokumenteve ligjore, ndërsa në disa prej tyre mungon<sup>31</sup>. Në vlerësimin e këtij treguesi konsiderohen edhe konkluzionet lidhur me vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nga analiza e të cilëve rezulton shkallë shumë e lartë kujdesi e gjyqtarës për të identifikuar dhe përcaktuar qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes dhe për të identifikuar ligjin e zbatueshëm, si në lidhje me aspektet procedurale ashtu edhe ligjin material në funksion të zgjidhjes së çështjes.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

<sup>26</sup> Vendim nr. 686/2229, datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;

<sup>27</sup> Vendimi nr. 849/1847, datë 23.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;

<sup>28</sup> Vendim nr. 1115/4093, datë 28.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;

<sup>29</sup> Vendim nr. 1115/4093, datë 28.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;

<sup>30</sup> Vendim nr. 686/2229, datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;

<sup>31</sup> Relacion për çështjen penale me nr. 56430-00489-00-2014 me të pandehur M.Hala, relacion për çështjen penale me nr. 53101-01334-00-2013 me të pandehur A.Hudhra dhe S. Brasha dhe relacion me nr. 53101-00394-00-2014 me të pandehur D.Xhangolli dhe E.Metaliaj.

## 1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ÇËSHTJET LIGJORE MATERIALE DHE PROCEDURALE, PËR TË CILAT I KËRKOHET PËRGATITJA E ANALIZËS APO OPINIONIT LIGJOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, lidhur detyrat e ndihmësit ligjor, në nenin 21 parashikohet se : *“Ndihmësit ligjorë studiojnë ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisin relacionet për çështjet që janë në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjen ankesave, përgatisin materialet e nevojshme si dhe kryejnë çdo detyrë tjetër që u ngarkohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë.”*. Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë, e miratuar me urdhrin e Kryetari të Gjykatës nr. 214, datë 12.09.2014, në nenin 25, pika 1 të tij parashikon se : *“Ky relacion përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, kundërpadisë dhe ndërhyrjes kryesore (kur ka), bazën ligjore të padisë dhe të kundërpadisë, rrethanat dhe natyrën juridike të konfliktit, shkaqet e rekursit, mendimin e tij si dhe materialet e tjera që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes.”*.

Sa më sipër, interpretimi i ligjit procedural dhe/ose material të zbatueshëm në funksion të mbështetje të opinionit të ndihmësmagjistratit për zgjidhjen e çështjes, paraqet rëndësi me qëllim përmbushjen në mënyrë cilësore të funksionit të tij ndihmës për Kolegjin, në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes konkrete.

Në dokumentet ligjore burim vlerësimi, normat procedurale dhe materiale relevante për zgjidhjen e çështjes, identifikohen dhe, sipas rastit aplikohen drejtpërdrejt, ose interpretohen në mënyrë të shkurtuar, dhe më pas aplikohen mbi faktin konkret, në shërbim të konkluzionit të arritur nga ndihmësmagjistrati në mbështetje të opinionit të tij mbi zgjidhjen e çështjes. Interpretimi i normave ligjore të zbatueshme, evidentohet kryesisht në lidhje me normat e ligjit penal material, ndërsa sa i përket normave të ligjit procedural ato thjesht referohen si dispozita në përmbajtje të konkluzionit për ekzistencën ose jo të shkaqeve të rekursit/kërkesës për rishikim, pa iu nënshtruar interpretimit.

Në dokumentet ligjore të analizuara, ka një ndryshim thelbësor mbi mënyrën dhe masën e interpretimit të normave ligjore procedurale ose materiale dhe për këtë arsye, burimet e vlerësimit, për efekt të vlerësimit të këtij treguesi kategorizohen në tre grupe: (i) dokumente ligjore në të cilat interpretimi i ligjit procedural ose material mungon, (ii) dokumente ligjore në të cilat ka identifikim dhe referim të ligjit po mungon interpretimi dhe (iii) dokumente ligjore në të cilat ka interpretim të normave ligjore procedurale dhe/ose materiale.

***Në grupin e dokumenteve ligjore në të cilat ka interpretim të dispozitave ligjore,*** rezulton interpretim i normave ligjore si më poshtë:

- (i) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. akti 52111-0875-00-2011 ndaj të pandehurit S.Ndoj, në mendimin e ndihmësit ligjor, referohet neni 323 i Kodit Penal në funksion të çështjet të shtruar për diskutim, nëse largimi i personit që është nën masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, ndodhemi para elementëve të figurës së veprës penale “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit.
- (ii) Në relacionet e çështjeve penale me nr. 86000-00043-00-2014 me kërkues E.Belulaj, dhe nr. 86000-00402-00-2014 me kërkes T.Zeqo, interpretohet shkurtimisht neni 64 i Kodit Penal, në funksion të konkluzionit se në rastet përkatëse lirimi me kusht është aplikuar për shkak të prezencës së kushteve të veçanta të aplikimit të këtij neni.
- (iii) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 52102-00418-00-2011 me të pandehur K.Balla, analizohen në raporte krahasimore elementët e anës subjektive të veprave penale të parashikuara nga nenet 76 në lidhje me nenin 22 dhe 88/1 të Kodit Penal, posaçërisht qëllimi i këtyre dy veprave.
- (iv) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 52104-00391-00-2012 me kërkues E.Kotorri, ka referim të nenit 450 të K.Pr.P lidhur me shkaqet e rishikimit dhe interpretim të tij duke u mbështetur në vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që ka konstatuar shkelje të nenit 6/1 të KEDNJ në lidhje me çështjen ndaj të pandehurit.

***Në dy dokumente ligjore të analizuara*** rezulton të jetë referuar ligji material i zbatueshëm por nuk ka interpretim të tij në funksion të çështjeve të mundshme për diskutim apo në mbështetje të mendimit të ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes. Konkretisht rezulton si më poshtë:

- (v) Në relacionin që i përket çështjes me nr. akti 56180-01434-00-2013 me të pandehuri S.Likaj dhe M.Ivziku, në mendimin e ndihmësit ligjor, referohen nenet 279 dhe 278/2 të Kodit Penal por nuk ka interpretim të tyre;

***Në dokumentet e tjera ligjore*** nuk rezulton në asnjë rast interpretim i normave ligjore procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes por identifikohet vetëm referimi në nenin 432 të K.Pr.P lidhur me prezencën ose jo të shkaqeve të rekursit.

***Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës,*** në dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se, pavarësisht se nuk janë identifikuar më mënyrë të shprehur, referohen parimet procedurale të ligjshmërisë së marrjes së provës<sup>32</sup> dhe procesit të rregullt ligjor<sup>33</sup>.

***Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante,*** në 8 nga 9 dokumentet ligjore të analizuara, nuk rezulton në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor, referimi ose analiza në jurisprudencën relevante vendase ose ndërkombëtare. Në një rast referohet si pjesë e përmbajtjes së relacionit vendimi i GJEDNJ-së “Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë”, dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 23.02.2011, por ky referim nuk është bërë në kuadrin e

---

<sup>32</sup> *Relacion i çështjes penale me nr. 53101-00394-00-2014 dhe relacion i çështjes penale me nr. 52104-00391-00-2012;*

<sup>33</sup> *Relacion i çështjes penale me nr. 52104-00391-00-2012;*

jurisprudencës relevante, por si pjesë e ecurisë procedurale të çështjes konkrete dhe shkakut të rishikimit të vendimit penal konkret<sup>34</sup>.

*Në tërësi*, në dokumentet ligjore të analizuara, vetëm në katër prej tyre rezultojnë të ketë interpretim të dispozitave ligjore procedurale ose materiale që zbatohen në zgjidhjen e çështjes. Edhe në ato dokumentet ligjore ku ky interpretim ekziston, ai është i kufizuar dhe nuk rezultojnë të ketë një interpretim të pavarur të normës, para aplikimit mbi shkaqet e ngritura në rekurs, pasi dispozitat ligjore referohen dhe/ose aplikohen drejtpërdrejt mbi faktin apo në mbështetje të çështjes të ngritur për diskutim, pa dhënë arsye për mënyrën e aplikimit të tyre, përveç një rasti kur dispozitat analizohen në nivel krahasues në lidhje me elementët e anës subjektive të veprave penale. Po ashtu nuk rezultojnë të ketë referim në praktikën gjyqësore relevante, në mbështetje të opinionit ligjor mbi mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes konkrete.

*Lidhur me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”*, në katër vendimet gjyqësore burim vlerësimi, dispozitat ligjore të evidentuara si të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, shoqërohen në çdo rast me interpretimin e kuptimit dhe qëllimit të tyre, para aplikimit mbi faktin konkret në shërbim të të cilit ato analizohen. Në lidhje me normat procedurale, gjyqtarja ka interpretuar dispozita të ligjit procedural civil vetëm në rastet kur kjo është e nevojshme, sikurse është interpretimi i nenit 192 të K.Pr.C lidhur me vlerësimin e gjyqtarës për rrëzimin e kërkesës për thirrjen e personit të tretë në gjykim<sup>35</sup>, nenin 32 shkronja b) dhe c) lidhur me legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve ndërgjyqëse në padinë e njohjes së pavërtetësisë së dokumentit<sup>36</sup> dhe nenin 32/a të K.Pr.C, për të vlerësuar legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve ndërgjyqëse në raport me objektin e padisë për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues<sup>37</sup>.

Sa i përket dispozitave me karakter material, të identifikuar si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, gjyqtarja interpreton në mënyrë të zgjeruar, duke integruar më pas edhe faktet e provuara në gjykim, në funksion të mbështetjes së arsyetimit të saj, në sërë dispozitash si më poshtë:

- interpretimi i nenit 169 të Kodit Civil, duke analizuar natyrën e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues pa titull si mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë, kushtet ligjore dhe faktike që duhet të plotësohen sipas kësaj dispozite, momentin kohor të parashikimit të kësaj mënyrë të fitimit të pronësisë, duke iu referuar dispozitave kalimtare të Kodit Civil të miratuar në vitin 1994<sup>38</sup>.
- interpretimi i nenit 609 të K.Pr.C, i cili nga përmbajtja e tij përbën dispozitë me karakter material, lidhur me përcaktimin dhe analizën e shkaqeve që përbëjnë pavlefshmëri të titullit ekzekutiv<sup>39</sup>.
- Interpretimi i nenit 608 të Kodit Civil lidhur me kushtet për ekzistencën e dëmit jashtëkontraktor dhe kërkimin për shpërblimin e tij<sup>40</sup>;
- Interpretim i neneve 112 dhe 125 të Kodit Civil lidhur me institutin e parashkrimit të padisë për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe neneve 705, 713, 710, 715 e vijues të Kodit Civil

<sup>34</sup> *Relacion për çështjen penale me nr. 52104-00391-00-2012 me kërkuar Elidon Kotorri me objekt “Rishikim vendimi”.*

<sup>35</sup> *Vendim nr. 686/2229, datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

<sup>36</sup> *Vendim nr. 692/2247, datë 25.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

<sup>37</sup> *Vendimi nr. 1115/4093, datë 28.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

<sup>38</sup> *Vendimi nr. 1115/4093, datë 28.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

<sup>39</sup> *Vendim nr. 686/2229, datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

<sup>40</sup> *Vendim nr. 686/2229, datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

lidhur me kuptimin e kontratës së shitjes, objektin e saj, detyrimet e palëve, të metat thelbësore të sendit, etj.<sup>41</sup>.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, gjyqtarja zbaton *parimin e procesit të rregullt ligjor*, pa përmendur shprehimisht elementë të këtij parimi, por referuar kontekstit të arsyesimit të vendimeve, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejt aspekte të tij në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, kontradiktoritetin, barrën e provës, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim...etj. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi ka analizë të parimeve të “*gjësë së gjykuar*”<sup>42</sup>, duke mbështetur argumentimin edhe me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 12, datë 17.03.2014, dhe parimit të zbatimit të ligjit material në kohe, duke iu referuar dispozitave tranzitore të Kodit Civil<sup>43</sup>.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtares për të përdorur jurisprudencën relevante, në një nga vendimet të analizuara, referuar objektit të mosmarrëveshjes, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante duke iu referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 12, datë 17.03.2014, lidhur me parimin e gjësë së gjykuar<sup>44</sup>.

Parashtrimi i gjyqtares se pjesa e mendimit të ndihmësit ligjor shtjellohej në varësi të çështjes që relatohej dhe, për çështjet e përfunduara me mospranim rekursi, relacioni nuk përmban interpretim të ligjit, është konsideruar në vlerësim duke i ndarë në grupe burimet e vlerësimit, dhe duke konsideruar edhe natyrën komplekse ose jo të dokumentet ligjor, referuar përmbajtjes së tij.

Duke konsideruar natyrën e punës së ndihmësit ligjor, si dhe praktikën e punës së Gjykatës së Lartë për trajtimin e çështjeve sipas natyrës së tyre, në asnjë rast vlerësimi nuk është bazuar mbi konstatimin e ekzistencës ose jo të një analizë të hollësishme ligjore mbi zgjidhjen e çështjes apo interpretim të plotë dhe të detajuar të ligjit të zbatueshëm. Në rastin konkret, duke mbajtur në vëmendje pikërisht natyrën e punës së ndihmësit ligjor si dhe praktikën e punës së Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, analiza dhe vlerësimi është bërë duke iu referuar evidentimit ose jo prej tij, të një interpretimi minimal, në kuadër të mbështetjes së mendimit të ndihmësit për zgjidhjen e çështjes, interpretim i cili në një pjesë të dokumenteve ligjore të analizuara mungon tërësisht.

Sa i përket parashtrimeve të gjyqtares se aftësitë e saj profesionale janë vlerësuar maksimalisht në vlerësimet e Kolegjit Penal, këto vlerësime përbëjnë burim në vlerësim dhe janë konsideruar në vlerësimin e çdo treguesi të aftësive profesionale të gjyqtares.

---

<sup>41</sup> Vendim nr. 849/2847, datë 23.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

<sup>42</sup> Vendim nr. 686/2229, datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

<sup>43</sup> Vendim nr. 1115/4093, datë 28.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

<sup>44</sup> Vendim nr. 686/2229, datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Sa i përket kërkimit për të konsideruar si burim në pikëzimin e treguesve të aftësive profesionale angazhimin e saj për të qenë pjesë e projektit për hartimin e përmbledhjes së vendimeve unifikuese, kjo veprimtari është konsideruar në vlerësimin dhe pikëzimin e treguesit përkatës, “4.c.ç Publikimet ligjore akademike”.

## KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka aftësi në interpretimin të ligjit procedural dhe material, në mbështetje të opinionit ligjor në lidhje me zgjidhjen e çështjeve konkrete të ngritura në rekurs, por ky interpretim shfaqet tepër i kufizuar dhe evidentohet vetëm në disa prej dokumenteve ligjore të analizuara, ndërsa në pjesën tjetër të tyre, interpretimi i ligjit procedural ose material mungon. Në vlerësimin e këtij treguesi konsiderohen edhe vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në të cilat, rezulton një shkallë e lartë aftësie për të interpretuar ligjin procedural dhe material në zgjidhjen e çështjes. Por duke i konsideruar burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, pa i dhënë vlerë të paracaktuar asnjërit prej tyre, në kushtet kur prezenca e interpretimit ligjor evidentohet vetëm në një pjesë të dokumenteve ligjore (relacione) të analizuara dhe mungesa e tij në pjesën tjetër të tyre, vlerësohet se ato tregojnë shkallë aftësie “mbi mesataren” të ndihmësmagjistrates për këtë tregues.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “mbi mesataren” duke u pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së ndihmësmagjistratit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha dokumentet ligjore burim vlerësimi, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.*

## 1.B. ARSYETIMI LIGJOR

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Relacioni dokument ligjor i paraqitur prej saj dhe tre relacionet si ndihmëse ligjore janë shkruar qartë dhe në mënyrë të kuptueshme, me strukturë të mirëorganizuar, duke u evidentuar edhe mendimi i subjektit për pretendimet e ngritura. Vetë subjekti i rivlerësimit duke që përdor të njëjtën strukturë në hartimin e relacioneve. Por konstatohet që megjithëse argumentet e ndihmësit ligjor janë të listuara, mendimi i tij nuk është gjithnjë i qartë dhe nuk përmban propozim konkret për zgjidhjen e çështjes. Në 3 relacionet e vëzhguara, në dy raste mendimi i ndihmësit ligjor përputhet me vendimmarrjen e gjykatës (shih dosjet 3 dhe 4), por në një prej tyre mendimi i ndihmësit ligjor nuk përputhet me vendimmarrjen e gjykatës (shih dokumentin 5), por është i njëjtë me vendimmarrjen për kalimin e çështjes për gjykim. Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, por jo gjithnjë ka përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i

shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil (shih dokumentet 2 e 3 dhe dosjet 1 e 2). Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja mes fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet me pjese nga praktika e Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentin 1 dhe dosjen 1). Një tipar i mirë i punës së saj është fokusimi në arsyetimin e vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit i mosmarrëveshjes, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetimin e tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor....Gjithashtu tek 2 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore”.

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me aspektin e njohurive ligjore, konkludohet se :”E aftë për të shkruar thjesht dhe qartë projekt vendimet gjyqësore, që rezultojnë të kuptueshme nga të gjithë.”<sup>45</sup>”

## **1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E DOKUMENTIT LIGJOR**

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes në përmbushje të detyrës së ndihmësit ligjor në funksion të relativitetit të qartë, konciz, tërësor dhe lehtësisht të kuptueshëm të çështjes para Kolegjit përkatës së Gjykatës së Lartë.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, lidhur me këtë tregues vlerësohet qartësia, konciziteti, elokuenca dhe lehtësia në kuptimin dhe leximin e dokumenteve ligjore, aftësia për të prezantuar verbalisht çështjen para Kolegjit kur i kërkohet, aftësia për të përmbledhur shkaqet e rekursit, procedurën e zbatueshme, arsyetimin e gjykatave me të ulëta dhe çështjet e tjera ligjore.

Në rastin konkret, referuar të dhënave që rezultojnë nga dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se gjuha e përdorur nga ndihmësmagjistratja është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme. Përgjithësisht janë përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, janë respektuar rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve dhe

---

<sup>45</sup> Ky vlerësim lidhur me aftësitë profesionale juridike dhe teknike, në treguesin “Qartësia dhe shkruarit të vendimit”, është i njëjtë në të gjitha aktet e vlerësimit nga Kolegji Penal.

fjalive, duke i bërë aktet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte, në funksion të kuptueshmërisë dhe qartësisë së përmbajtjes së tyre. Nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i termave teknikë.

Ndihmësmagjistratja përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, të qarta dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Paragrafët dhe nënndarjet e përmbajtjes së dokumentit ligjor janë të lidhura me njëra tjetrën dhe nuk krijojnë shkëputje të logjikës së ndërtimit të tyre, brenda së njëjtës nënndarje të dokumentit ligjor apo në tërësi.

Sa i përket paraqitjes së mendimit të ndihmësit ligjor, evidentohet një shkallë e lartë kujdesi në paraqitjen e plotë dhe të qartë të mendimit të ndihmësit ligjor dhe arsytimit përkatës në mbështetje të tij, pavarësisht se në disa raste pjesa arsyetuese e mendimit është më e kufizuar krahasuar me pjesën tjetër të dokumenteve ligjore. Kjo e fundit kushtëzohet edhe nga natyra e çështjesh, pasi në disa raste mendimi i ndihmësit ligjor referon në mungesën e shkaqeve të rekursit sipas parashikimeve të ligjit procedural, shoqëruar me paraqitjen në mënyrë të shkurtuar të arsyes mbi të cilën mbështetet ky vlerësim.

Sa i përket aftësive të ndihmësmagjistrates për të prezantuar verbalisht çështjet para Kolegjit, nga burimet e vlerësimit në tërësi, nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta për këtë aspekt, por referuar vlerësimeve të Kolegjit për atësitë profesionale të ndihmësmagjistrates, të gjithë komponentët e këtij kriteri janë vlerësuar maksimalisht.

***Lidhur me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”***, në katër vendimet gjyqësore burim vlerësimi, gjyqtarja ka është e qartë, e kuptueshme dhe konkrete. Në referimin e instituteve dhe parimeve të së drejtës që përmenden në arsyetim gjithnjë i referohet në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për kuptimin e tyre për lexuesin. Nuk evidentohet në asnjë rast përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Ashtu si në dokumentet ligjore burim vlerësimi, edhe në vendimet gjyqësore të analizuara, gjyqtarja përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, duke i bërë vendimet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi normale, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe në rrjedhë logjike. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve dhe përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të organizuara sipas në vijueshmërie logjike.

## **KONKLUZIONE**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja tregon kujdes të posaçëm për pasqyrimin qartë, konciz dhe të saktë të fakteve të çështjes, ecurisë procedurale të gjykimit, shkaqeve të rekursit ose mjetit tjetër ligjor me të cilin është investuar Gjykata e Lartë. E njëjta shkallë kujdesi evidentohet në drejtim të kuptueshmërisë të mendimit të



ndihmësit ligjor lidhur me zgjidhjen e çështjes apo evidentimin e çështjeve për diskutim para Kolegjit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

## **1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E DOKUMENTIT LIGJOR**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Dokumentet ligjore të hartuar nga ndihmësmagjistratja ndjekin strukturë të njëjtë dhe të standardizuar duke përmblotur elementët thelbësore të relacionit sipas parashikimeve të Rregullores së Brendshme e Gjykatës së Lartë, e miratuar me urdhrin e Kryetari të Gjykatës nr. 214, datë 12.09.2014, në nenin 25, pika 1 të së cilës parashikohet se : *“Ky relacion përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, kundërpadisë dhe ndërhyrjes kryesore (kur ka), bazën ligjore të padisë dhe të kundërpadisë, rrethanat dhe natyrën juridike të konfliktit, shkaqet e rekursit, mendimin e tij si dhe materialet e tjera që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes.”.*

Përmblotja e dokumenteve ligjore, përgjithësisht është e ndarë në paragrafë, të cilët lidhen me njëri tjetrin duke krijuar vijueshmëri dhe duke iu përmblotur nënndarjes përkatëse. Përdorimi i titujve mundëson lexim të organizuar të dokumentit ligjor dhe respektim të strukturës standarde të miratuar, mbi bazën e së cilës hartohet dokumenti ligjor (relacioni).

Relacionet e përgatitura nga ndihmësi ligjor, të organizuara sipas të njëjtës strukturë, përmblotjnë në pjesën hyrëse identifikimin e çështjes, të dhënat e palëve ndërgjyqëse, objektin dhe bazën ligjore (*referencën në ligjin procedural në rastin e kërkesës për rishikim apo në ligjin material në lidhje me akuzën ndaj të pandehurit apo kërkesave për lirim para kohe me kusht*). Përmblotja e relacioneve është e organizuar në disa pjesë, të identifikuar me titujt përkatës sipas përmblotjes, si më poshtë: (i)*rrethanat e çështjes*. Në këtë pjesë përshkruhen në mënyrë të përmblotshme rrethanat e faktit lidhur me çështjen objekt gjykimi; (ii)*procedura gjyqësore*, shoqëruar me paraqitjen e vendimmarrjes së gjykatave të faktit dhe paraqitjen në mënyrë të përmblotshme të pjesëve thelbësore të arsytimit të vendimeve; (iii)*rekursi ose kërkesa për rishikim dhe shkaqet*. Në këtë pjesë pasqyrohet ushtrimi i së drejtës së rekursit nga palët duke renditur në mënyrë të përmblotshme shkaqet thelbësore të rekursit, shoqëruar në disa raste me pjesë të arsytimit të shkaqeve, sipas pretendimeve të palës që ka investuar gjykatën;

(iv) *Mendimi i ndihmësit ligjor ose mendim për zgjidhjen e çështjesh*. Në këtë pjesë të relacionit parashtrohet vlerësimi për njoftimin e rekursit dhe paraqitjen e tij në formën e kërkuar nga ligji. Më pas parashtrohet shkurtimisht konkluzioni i ndihmësit ligjor lidhur me prezencën ose jo të shkaqeve ligjore të rekursit/kërkesës për rishikim, dhe më tej jepen arsyet që mbështesin mendimin e ndihmësit, duke referuar në disa raste dispozitat e ligjit procedural/material të zbatueshëm, si dhe argumenteve ligjore që mbështesin mendimin e dhënë apo çështjet e ngritura për diskutim kur është rasti<sup>46</sup>.

*Në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”*, në katër vendimet gjyqësore burim vlerësimi, konstatohet se gjyqtarja ndjek kryesisht të njëjtën strukturë, e cila është qëndrueshme, e organizuar dhe e standardizuar. Vendimet gjyqësore përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin, sipas parashikimeve të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile.

Në pjesën hyrëse të vendimit gjen pasqyrim trupi gjykues që ka dhënë vendimin, sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët ndërgjyqëse (*me të dhënat për gjeneralitetet, adresën dhe përfaqësimin në gjykatë*), objekti i mosmarrëveshjes civile dhe kërkimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse.

*Pjesa përshkuese arsyetuese* është e ndarë sipas përmbajtje, edhe pse jo gjithnjë e dukshme në aspektin vizual, pjesë në të cilat në mënyrë të detajuar pasqyrohen:

(i) vlerësimi i gjykatës lidhur me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, ecuria procedurale e çështjesh duke evidentuar në raste të caktuara elementë të rëndësishëm proceduralë sikurse është rasti i rrëzimit të kërkesës për thirrjen e personit të tretë ; (ii) faktet e çështjes referuar pretendimeve të palëve të cilat paraqiten në mënyrë të plotë dhe duke evidentuar shpesh edhe argumentet ligjore të tyre; (iii) identifikimi dhe përcaktimin i natyrës së mosmarrëveshjes, identifikimi i ligjit të zbatueshëm; (iv) ngritja e çështjeve (në formë pyetjesh) të cilat është vlerësuar se duhet ti jepen përgjigje në arsyetim, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes<sup>47</sup>; (v) procesi analitik i vlerësimit të provave, interpretimi abstrakt i ligjit dhe argumentimi i zbatimit të tij mbi faktet e provuara ; (vi) Analiza e detajuar e çështjeve të ngritura për diskutim si dhe e çdo pretendimi të palëve, e cila përfundon me një konkluzion më vete përmbyllës, tërësia e të cilëve përbën konkluzionin përfundimtar mbi zgjidhjen e çështjes.

*Në pjesën e dispozitivit* gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, i cili është rrjedhojë e analizës së kryer nga gjykata në pjesën përshkuese–arsyetuese. Dispozitivi përmban disponimin për pranimin ose rrëzimin e padisë, pagimin e shpenzimeve gjyqësore si dhe të drejtën e ankimit dhe afatin e ushtrimit të saj.

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të dokumentit ligjor, pavarësisht përmbajtjes që ka secila ndarje. Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike e rrjedhshmërisë së mendimit juridik, nga njëra pjesë e dokumentit ligjor në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin.

<sup>46</sup> *Relacion për çështjen penale me nr. 52111-00875-00-2011, që i përket të pandehurit S.Ndoj; Relacion për çështjen penale me nr. 52101- 00394-00-2014, që i përket të pandehurve D.Xhgolli dhe E.Metaliaj;*

<sup>47</sup> *Vendimi nr. 686/2229, datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e dokumentit ligjor” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

## **1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIMIT LOGJIK**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, lidhur me të tregues, vlerësohet cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore, aftësia për të identifikuar marrëdhënien shkak-pasojë si dhe për të analizuar se si konceptet, institutet e së drejtës dhe dispozitat lidhen midis tyre ose se si ato zbatohen mbi një situatë të caktuar, përmbajtja gjithëpërfshirëse e dokumentit ligjor si dhe evidentimi i nevojës për të njehsuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

Burimet e vlerësimit, referuar përmbajtjes së pjesës në të cilën pasqyrohet mendimi i ndihmësit ligjor, lidhur me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, paraqesin karakteristika të ndryshme dhe ndahen në dy grupe:

***(i) dokumente ligjore në të cilat mendimi i ndihmësit ligjor parashtrohet shkurtimisht dhe analiza dhe argumentimi logjik është i kufizuar, duke vështirësuar vlerësimin e komponentëve dhe cilësisë së tij.*** Konkretisht :

- 1) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 53101-00394-00-2014 mendimi i ndihmësit ligjor përbëhet nga vlerësimi paraprak për paraqitjen e rekursit sipas formës së parashikuar nga ligji dhe njoftimi i tij palëve, si dhe parashtrimi i çështjes për diskutim, duke iu referuar konkluzioneve të ndryshme lidhur me ekzistencën e veprës penale nga gjykata e apelit, në raport me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, por nuk rezulton në mendimin e ndihmësit ligjor analiza apo argumentimi logjik lidhur me përgjigjen që duhet të marrin shkaqet e ngritura në rekurs apo argumente mbështetëse lidhur me çështjen e ngritur për diskutim;
- 2) Në relacionin që i përket çështjes penale me numër 56430-00489-00-2014 mendimi i ndihmësit ligjor është pasqyruar në tre fjali që konsistojnë në vlerësimin për paraqitjen në formën e kërkuar nga ligji dhe komunikimin e rekursit. Mendimin i ndihmësit ligjor se rekursi nuk përmban shkaqe ligjore mbështetëse në argumentin se pretendimet e palëve janë trajtuar nga gjykatat e faktit, por nuk rezulton të ketë analizë dhe argumentim logjik në mbështetje të këtij konkluzioni;

- 3) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 56180-01434-00-2013, mendimi i ndihmësit është pasqyruar në dy fjali që konsistojnë në vlerësimin për paraqitjen në formën e kërkuar nga ligji dhe komunikimin e rekursit dhe mendimin i ndihmësit për mungesën e shkaqeve të rekursit, pasi çështjet e ngritura në të lidhur me vlerësimin e provave dhe fajësinë e të pandehurve, janë vlerësuar nga gjykatat e faktit;
- 4) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 53101-01334-00-2013, mendimi i ndihmësit është pasqyruar në dy fjali që konsistojnë në vlerësimin për paraqitjen në formën e kërkuar nga ligji dhe komunikimin e rekursit dhe mendimin i ndihmësit për mungesën e shkaqeve të rekursit, pasi çështjet e ngritura lidhur me kriteret ligjore të caktimit dhe individualizimit të dënimit, janë vlerësuar nga gjykatat e faktit;

Pavarësisht sa më sipër, evidentohet fakti se relacionet për çështjet penale si më sipër, kushtëzohen edhe nga natyra e çështjeve dhe shkaqeve të rekursit të paraqitura nga pala që ka investuar gjykatën, si pasojë e të cilave, vlerësimi i ndihmësit ligjor paraqitur nëpërmjet mendimit të tij për zgjidhjen e çështjeve, është ndaluar shkurtimisht vetëm në aspektin procedural të ekzistencës ose jo të shkaqeve të rekursit.

*(ii) dokumente ligjore në të cilat mendimi i ndihmësit përmban analizë dhe argumentim logjik.* Konkretisht :

- 5) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 52111-00875-00-2011, në mendimin e ndihmësit ligjor është ngritur për diskutim në dhomë këshillimi ekzistenca e veprës penale të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal, në rastin kur personi ndodhet nën masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”. Pavarësisht çështjes të ngritur për diskutim, mendimi i ndihmësit ligjor nuk përmban elementë të analizës dhe argumentimit lidhur me këtë çështje të vlerësuar si të nevojshme për diskutim nga Kolegji dhe as analizë të dispozitës konkrete të Kodit Penal në shërbim të vlerësimit të kësaj çështje të sugjeruar për diskutim Kolegjit.
- 6) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 52102-00418-00-2011, në mendimin e ndihmësit ligjor merren në analizë çështje që lidhen me kualifikimin ligjor të faktit penal, duke analizuar fillimisht elementët e anës subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 76 në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal në raport me veprën penale të parashikuar nga neni 88/1 i K. Penal. Analiza ligjore bëhet duke i vendosur përballë njëra tjetrës dispozitat, duke evidentuar posaçërisht qëllimin e secilës veprë penale. Pas kësaj analize në nivel krahasues të dispozitave të ligjit material, ndihmësja ligjore analizon dhe argumentin lidhur me rrethanat e faktit të provuara në gjykim, në raport me parashikimet e ligjit penal material, duke bërë një analizë të plotë dhe tepër koncize të elementëve të faktit në raport me ligjin, në shërbim të konkluzionit logjik të arritur lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal.
- 7) Në relacionet që i përkasin çështjeve penale me nr. 86000-00402-00-2014 dhe nr. 86000-00043-00-2014, në mendimin e ndihmësit ligjor, në shërbim të konkluzionit për mungesën e shkaqeve të rekursit, përveç referimit në nenin 64 të Kodit Penal dhe ligjin e posaçëm për ekzekutimin e dënimeve penale, sa i përket kushteve për aplikimin e lirimit para kohe me kusht, jepen argumente lidhur me provat e administruara nga gjykatat e faktit në drejtim të plotësimit dhe provueshmërisë së ekzistencës së kriterëve ligjore të aplikimit të këtyre dispozitave.
- 8) Në relacionin që i përket çështjes penale me nr. 52104-00391-00-2012 mendimi i ndihmësit ligjor fillon me konkluzionin lidhur me ekzistencën e shkaqeve ligjore për

rishikimin e vendimit, referimin e pjesës thelbësore të vendimit të GJEDNJ lidhur me çështjen, argumentimin lidhur me mënyrën e marrjes së provave dhe ekzistencën e shkeljeve të nenit 6/1 dhe 6/3 të KEDNJ, referuar konkluzioneve të kësaj gjykate si dhe referimin dhe citimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me përcaktimin e kompetencës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e kërkesës për rishikim të vendimit. Pavarësisht se mendimi i ndihmësit ligjor në pjesën me të madhe të tij referon dhe citon konkluzionet e vendimit të GJEDNJ dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen, në mbështetje të shkaqeve ligjore për rishikimin e vendimit, paraqitja dhe analiza e tyre nga ndihmësi ligjor është e qartë dhe koncize, në funksion të mbështetjes së mendimit të dhënë prej saj për ekzistencën e shkaqeve ligjore të parashikuara nga neni 450 i K.Pr.P për rishikimin e vendimit.

*Në tërësi, në dokumentet ligjore si më sipër, rezulton se ndihmësmagjistratja ka treguar kujdes në analizimin e qartë të fakteve thelbësore të çështjes që lidhen me pretendimet e ngritura nga palët në recurs, duke i analizuar ato në disa raste në mënyrë të përmbledhur dhe në formën e një konkluzioni dhe në disa raste të tjera komplekse në mënyrë më të detajuar, por në çdo rast në mënyrë logjike dhe të kuptueshme. Analiza e fakteve thelbësore apo çështjeve ligjore që janë bërë objekt rekursi, bëhet në disa raste duke integruar analizën ligjore të dispozitave të zbatueshme, në shërbim të konkluzionit të paraqitur që në pjesën hyrëse të mendimit të ndihmësit ligjor në lidhje me zgjidhjen e çështjes, apo ngritjen e çështjeve për diskutim para Kolegjit.*

Në tërësi, në dokumentet ligjore të analizuar si më sipër, nuk evidentohet e njëjta shkallë analize dhe argumentimi logjik pasi në disa prej tyre komponenti analitik bazohet kryesisht në konkluzionin mbi zgjidhjen e çështjes, pa u shoqëruar me një analizë paraprake se pse fakte të caktuara çojnë në këtë përfundim ligjor, kushtëzuar kjo edhe nga natyra jo komplekse e çështjeve konkrete për të cilat konkludohet për mungesën e shkaqeve ligjore të rekursit.

*Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve në recurs, në dokumentet e analizuar, rezulton aftësia e ndihmësmagjistrates për të veçuar dhe përmbledhur shkakun ose shkaqet thelbësore të rekursit, si dhe për të analizuar kur është rasti, atë fakt apo pretendim që ka rëndësi thelbësore për zgjidhjen e çështjes apo në funksion të evidentimit të çështjeve të ngritura për diskutim prej saj.*

Pavarësisht sa më sipër, në vlerësimin e Kolegjit evidentohet edhe kontributi dhe aftësia në nivel maksimal e ndihmësmagjistrates në përgatitjen e projekt-vendimeve gjyqësore për çështjet e relatuara, referuar akteve të vlerësimit të Kolegjit në të cilat kjo aftësi vlerësohet maksimalisht dhe për pasojë do të konsiderohet në vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi.

*Në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, në katër vendimet gjyqësore burim vlerësimi evidentohet si karakteristikë e gjyqtares, ekzistenca e një cilësie të lartë të analizës ligjore, ndërthurjen e saj me faktet e çështjes, analiza tërësore e pretendimeve të palëve dhe arritja e konkluzioneve për zgjidhjen e çështjeve të ngritura për diskutim dhe të mosmarrëveshjes në tërësi, mbi bazën e një argumentimi logjik të plotë dhe ezaurues. Spikat aftësia e gjyqtares në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila është e detajuar duke integruar në çdo rast provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni për provueshmërinë e fakteve konkrete. Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit si dhe*

kategorisë së çështjes, analiza ligjore zhvillohet mbi bazën e një ecurie logjike, jepen argumente për secilën çështje të ngritur për diskutim nga gjyqtarja, për cdo pretendim të palëve dhe për çdo kërkim të objektit të padisë, duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete. Karakteristike e arsytimit është evidentimi i qartë i lidhjes shkak- pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura. Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë në çdo rast pjesë e integruar e vendimit gjyqësor duke u pasqyruar fillimisht në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsytimit, ndërsa më pas merren në analizë më vetë, të ndërthurura me analizën e provave dhe interpretimin e ligjit, në funksion të dhënies së një përgjigje të argumentuar në aspektin e mbështetjes në ligj apo prova të tyre.

## KONKLUZIONE

Në tërësi, në dokumentet ligjore të analizuara, analiza ligjore dhe shkalla e argumentimit pavarësisht se në masë të ndryshme, kushtëzuar na natyra komplekse ose jo e çështjes, rezulton e lartë. Evidentohet qartë aftësia e gjyqtarës për të ekstraktuar dhe analizuar aspektet thelbësore në lidhje me shkaqet e ngritura në rekurs si dhe në disa raste, dhënia e argumenteve të plota dhe koncize lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural mbi këto fakte. Po ashtu rezulton aftësia e saj për të evidentuar çështjet ligjore që duhet të vlerësohen nga Kolegji, por jo në çdo rast çështjet e ngritura janë shoqëruar dhe me një analizë ligjore të saj lidhur me këto çështje. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së ndihmësmagjistrates, e vlerësuar kjo bashkë me mendimin e kolegjit për vlerësimin e punës së ndihmësmagjistrates në hartimin e projektvendimeve gjyqësore për çështjet e relatuar, aftësia e saj për këtë tregues vlerësohet “shumë e lartë”. Në pikëzimin e këtij treguese, konsiderohen edhe konkluzionet lidhur me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik në katër vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në të cilat rezultoi se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në këtë drejtim. Analiza dhe argumentimi logjik ndjek rregullin : fakt-çështje-normë-interpretim-konkluzion dhe argumentimi logjik ka vijueshmëri duke u evidentuar veçanërisht interpretimi individual i ligjit nga ana e saj. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates për treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” duhet të vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

### **Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit”**

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PROFESIONALE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e ndihmësmagjistratit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë e tij për të ndihmuar dhe kontribuar në mënyrë efektive në menaxhimin e çështjeve, nëpërmjet menaxhimit të kohës, planifikimin e çështjeve që ai përgatit për shqyrtim si dhe veprimet procedurale jashtë tyre, pa krijuar pengesa në ecurinë e gjykimit të çështjeve në Kolegj. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë ndihmësmagjistrati përdor kohën e tij në funksion të shqyrtimit të çështjeve nga Kolegji. Kjo aftësi vlerësohet sipas tri aspekteve: sasisë, shpejtësisë dhe metodologjisë.*

### 2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

#### 2.A.A. TREGUESI SASIOR NË PËRFUNDIMIN E DOKUMENTEVE LIGJORE PËR ÇËSHTJET GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *”...Subjekti i rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë, ku nga data 08.10.2013 deri në datë 13.11.2015, i janë caktuar gjithsej 366 çështje dhe ka përfunduar si ndihmese ligjore 366 relacione....Gjithashtu ka paraqitur edhe shkresën nr.215/1 prot., datë 26.01.2017 të lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Lartë, përmbajtja e të cilës nuk i konfirmon deklaratimet e saj....”.*

Në aktet e vlerësimit<sup>48</sup> të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet : *”..E aftë dhe efektive në përgatitjen e relacioneve të çështjeve si në aspektin sasior, duke realizuar numrin e çështjeve prej 20 dosje të vendosura në rregulloren e Gjykatës së Lartë, dhe në disa raste duke e tejkaluar, ashtu edhe në aspektin cilësor, duke dhënë mendime të argumentuara ligjërish për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve penale....”, “Për vitin 2012 (15 nëntor dhe dhjetor) ka relatuar 37 dosje penale, në vitin 2013 ka relatuar në total 285 çështje penale, nga të cilat 242 kanë përfunduar me mospranim rekursi dhe 43 kalim për shqyrtim në seancë gjyqësore*

<sup>48</sup> Akt i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 331, datë 31.07.2015 për periudhën e vlerësimit 15 nëntor 2012-31 dhjetor 2012, janar 2013- dhjetor 2013; Akt i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 332, datë 31.07.2015 për periudhën e vlerësimit janar 2014- dhjetor 2014; Akt i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 333, datë 31.07.2015 për periudhën e vlerësimit janar 2015- korrik 2015; Akt i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 14, datë 26.02.2016 për periudhën e vlerësimit gusht – 15 nëntor 2015;

*si dhe ka përgatitur 71 projektvendime gjyqësore penale.”, “..Për vitin 2014 ka relatuar në total 115 çështje penale, si dhe ka përgatitur 40 projektvendime gjyqësore penale, pasi nga muaji maj –dhjetor 2014 ka qenë me leje lindje.”, “...Për periudhën janar 2015- korrik 2015 ka relatuar në total 154 dosje penale si dhe ka përgatitur 13 projektvendime gjyqësore penale.”, “Për periudhën gusht – 15 nëntor 2015 ka relatuar në total 53 dosje penale si dhe ka përgatitur 7 projektvendime gjyqësore penale, duke përfshirë dhe një vendim unifikues penal dhe një vendim të kolegjeve të Bashkuara.”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit, referuar formatit të statistikave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për numrin e çështjeve të caktuara për relatin gjatë periudhës së vlerësimit por administrohen të dhëna vetëm për çështjet e përfunduara me vendim në Gjykatën e Lartë. Referuar akteve të vlerësimit të Kolegjit, rezultojnë të dhëna të pjesshme për çështjet e caktuara (*vetëm në disa nga aktet e vlerësimit*).

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit kalimtar së bashku me të dhënat shtesë të vëna në dispozicion nga Gjykata e Lartë me kërkesë të gjyqtarës<sup>49</sup>, si dhe të dhënave që rezultojnë për këtë tregues nga burimet e tjera të vlerësimit. Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, së bashku me të dhënat shtesë të konfirmuara nga Gjykata e Lartë, si dhe provave të administruara në dosjen e vlerësimit të dorëzuara nga gjyqtarja bashkë me kundërshtimet e saj, gjatë periudhës kohore nga data 08.10.2013 deri në datë 15.11.2015, rezultojnë të dhënat statistikore si më poshtë, për çdo vit kalendarik:

**Për vitin 2013** (08.10.2013-31.12.2013), për një periudhë kohore prej 2 muaj e 22 ditë, ndihmësmagjistratja {...} ka trajtuar si ndihmëse ligjore gjithsej **67 çështje**.

**Për vitin 2014** (01.01.2014-31.12.2014), për një periudhë kohore prej 4 muajsh<sup>50</sup>, ndihmësmagjistratja {...} ka trajtuar si ndihmëse ligjore gjithsej **98 çështje**.

**Për vitin 2015** (01.01.2015-15.11.2015), ndihmësmagjistratja {...} ka trajtuar si ndihmëse ligjore gjithsej **180 çështje**.

**Në total** për periudhën 08.10.2013-15.11.2015 ka përfunduar **345 çështje**.

Në dosjen e rivlerësimit nuk administrohen të dhëna statistikore për çështjet e përgatitura por të pa relatuar gjatë periudhës përkatëse dhe kjo e dhënë nuk mund të gjenerohet, referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale dhe dokumenteve të tjera të dosjes së rivlerësimit, nëpërmjet të cilave janë dërguar të dhënat statistikore të ndihmëses ligjore {...}.

<sup>49</sup>Gjykata e Lartë në datë 02.07.2021, nëpërmjet postës elektronike konfirmon se :”...Nga verifikimet e bëra në sistemin ICMIS rezulton se nga 71 çështjet e bashkëlidhura, 70 çështje i përkasin gjyqtarit relator z. Artan Zeneli, pjesë e grupit të menaxhimit të çështjeve ka qenë edhe znj. {...}.”. Bashkëlidhur emalit është përcjellë tabela e hartuar nga vetë gjyqtarja ku pasqyrohen 71 çështje nga të cilat 14 kalim për gjyq/rrëzim dhe 57 çështje mospranim.

<sup>50</sup> Në aktin e vlerësimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me nr. 332, datë 31.07.2015 për periudhën e vlerësimit janar 2014- dhjetor 2014, referohet se :”Për vitin 2014 ka relatuar në total 115 çështje penale, si dhe ka përgatitur 40 projektvendime gjyqësore penale, pasi nga muaji maj –dhjetor 2014 ka qenë me leje lindje.”



Sa i përket standardit sasior të punës së ndihmësmagjistratit në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky tregues pikëzohet duke iu referuar aftësisë së ndihmësmagjistratit për të përballuar ngarkesën në punë sipas një standardi minimal të caktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe urdhri i kryetarit për Njësinë e Shërbimit Ligjor, për çdo kategori çështjesh. Duke iu referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, rezulton se nuk ka pasur standard sasior të miratuar për çdo kategori çështjesh. I vetmi parashikim lidhur me këtë aspekt është ai i nenit 25, pika 2 të “Rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë”, në të cilin parashikohet se : “Çdo ndihmës ligjor i Gjykatës së Lartë përgatit për relativ jo më pas se 20 (njëzet) dosje në muaj.”.

Duke iu referuar këtij parashikimi të Rregullores dhe të dhënave statistikore të administruara, rezulton se gjatë periudhës 08.10.2013-15.12.2015, duke përjashtuar periudhën maj-dhjetor 2014 gjatë së cilës znj. {...} nuk ka ushtruar funksionin për shkak të lejes së lindjes dhe muajin gusht gjatë të cilit zhvillohet leja vjetore, rezulton se:

**Për vitin 2013** (2 muaj e 22 ditë) ka përgatitur për relativ 67 çështje ose rreth **24.5 çështje në muaj**;

**Për vitin 2014** (4 muaj) ka përgatitur për relativ 98 çështje ose **24.5 çështje në muaj**;

**Për vitin 2015** (9.5 muaj) ka përgatitur për relativ 180 çështje ose rreth **19 çështje në muaj**;

**Në total për gjithë periudhën si më sipër, rezulton të ketë përgatitur 345 çështje ose rreth 22 çështje në muaj.**

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësja ligjore {...} ka përgatitur për relativ mesatarisht 22 çështje në muaj, mbi standardin sasior në fuqi prej 20 çështjesh në muaj. Bazuar në Metodologjinë e Pikëzimit, një tregues sasior i tillë përkon me pikëzimin maksimal.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore, ndihmësmagjistratja pikëzohet me 15 pikë.*

## **2.A.B. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË DOKUMENTEVE LIGJORE PËR ÇËSHTJET GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “...Në analizë të këtyre të dhënave duhen evidentuar tre faktorë: i. subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar numrin e çështjeve për relativ që i janë caktuar dhe rrjedhimisht, rendimenti i punës së saj përcaktohet i plotë, për të përballuar ngarkesën në punë; ii. kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde

*minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë; iii. mungesa e të dhënave mbi kohën e caktimit të çështjeve për relativ dhe e datës së përfundimit të relacionit nga ndihmësi ligjor bën të pamundur llogaritjen e kohëzgjatjes së secilit relacion të ndihmësit ligjor të përzgjedhur me short për vlerësim..”.*

Në aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna.

Pavarësisht se në tabelat me të dhëna statistikore nuk administrohen të dhëna për numrin e çështjeve të caktuara për relativ për çdo vit kalendarik dhe as për të gjithë periudhën e vlerësimit në tërësi, llogaritja e rendimentit të përfundimit të çështjeve për gjithë periudhën e vlerësimit, do të bazohet në metodologjinë e mëposhtme :

Referuar standardit sasior në fuqi, në periudhën e vlerësimit, ndihmës magjistratit duhet ti jenë caktuar për trajtim (përgatitje për relativ) së paku 20 çështje në muaj, pra në total për periudhën e ushtrimit të funksionit të ndihmësit ligjor prej 17 muaj e 7 ditë (afërsisht 17 muaj), duhet ti jenë caktuar 340 çështje. Rendimenti i matur si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara me ato të caktuara, si më sipër, në këtë rast rezulton 101 % që sipas metodologjisë përkon me 15 pikë duke qenë se rezulton +99 %.

## **KONKLUZIONE**

Pavarësisht analizës së mësipërme statistikore, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga analiza logjike e gjithë ngarkesës së punës së ndihmësmagjistrates, pikëzimi për këtë tregues është 15 pikë, pasi ajo rezulton të ketë tejkaluar standardin sasior dhe rezulton me një rendiment prej 101 %.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin e rendimentit në përfundimin e dokumenteve ligjore, ndihmësmagjistratja pikëzohet me 15 pikë.*

## **2.B. AFTËSIA PËR TË PËRFUNDUAR NË KOHË ÇËSHTJET E NGARKUARA**

### **2.B.A. RESPEKTIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna lidhur me këtë tregues.

Në aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :  
”..E aftë për të përgatitur relacionet e çështjeve, brenda afateve kohore të përcaktuara nga gjyqtari pranë të cilit punon, bazuar edhe në kriteret e përcaktuara në rregulloren e gjykatës, dhe që i janë caktuar gjyqtarit nëpërmjet shortit elektronik.”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, nëpërmjet këtij treguesi vlerësohet aftësia e ndihmësmagjistratit për të përgatitur dokumentin ligjor brenda standardit minimal kohor të caktuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose urdhri i kryetarit për Njësinë e Shërbimit Ligjor, për çdo kategori çështjesh, si raport mes numrit të çështjeve për të cilat dokumentet ligjore janë përgatitur tej standardit, me numrin total të çështjeve të përgatitura.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosje si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësi, nuk rezultojnë të dhëna për të mundësuar përlllogaritjen e kohës së përgatitjes së dokumenteve ligjore. Po ashtu në periudhën e vlerësimit nuk rezulton që kuadri ligjor dhe nënligjor, të kishte të përcaktuar kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor.

Dokumentet ligjore të përzgjedhura me short për vlerësim nuk përmbajnë datën të hartimit të tyre. Po ashtu, aktet e dosjeve për këto çështje nuk përmbajnë asnjë të dhënë për datën e caktimit dhe datën e përfundimit të dokumentit ligjor (relacionit) nga ana e ndihmësmagjistratit.

Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Lartë<sup>51</sup>, në nenin 15 pika, 1 dhe 2 parashikon se: ”1. Mbledhja e kolegjit në dhomë këshillimi për shqyrtimin e rekursit zhvillohet në datat e caktuara nga kryetari i Kolegjit, pas konsultimit në anëtarët e tjerë të Kolegjit respektiv. 2.Ndihmësi ligjor i gjyqtarit relator duhet të ketë shpërndarë më parë për studim relacionin dhe materialet e tjera ndihmëse...”. Referuar këtij parashikimi, në mungesë të të dhënave për datën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor për përgatitjen e relacionit dhe për datën e përfundimit të tij, si dhe në mungesë të të dhënave për datën e caktimit e seancës për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, do të prezumohet se relacioni është përgatitur nga ndihmësi ligjor para datës së relatimit të tij para Kolegjit, brenda standardeve kohore të arsyeshme.

Nga çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, sa i përket kohëzgjatjes së përgatitjes së relacionit, duke iu referuar arsytimit si më sipër, rezulton se:

- i) Çështja me nr. 53101-00394-00-2014, që i përket të pandehurve D.Xh dhe E.M, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datë 11.03.2014. Kolegji Penal me vendimin e datës 13.10.2015 ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim. Çështja është shqyrtuar në seancat gjyqësore të datave 10.02.2016 dhe 02.03.2016. Relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor nuk përmban datë por logjikisht është përfunduar para shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi në datë 13.10.2015. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori.  
***Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.***

---

<sup>51</sup>Rregullore e miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.09.2014 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

- ii) Çështja me nr. 57010-00719-00-2010 akti, që i përket të pandehurve I.A, R.C etj., akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 143/2, 184/2 dhe 300 të Kodit Penal, rezulton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datë 31.05.2010. Në dosje nuk ka të dhëna për datën e shortimit të saj apo vënies në lëvizje nga gjyqtari relator. Administrohet relacioni i cili tek emri i ndihmësit ligjor pasqyron ndihmësin F.C dhe jo ndihmesën ligjore {...}. Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ky dokument është vlerësuar se i përket subjektit {...} dhe është konsideruar në vlerësimin e saj, pasi pasqyrohet në tabelat me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Lartë për këtë subjekt. Relacioni i hartuar nga ndihmësi ligjor nuk ka datë ndërkohë që ai është përgatitur para datës 08.03.2012, datë në të cilën çështja është shqyrtuar në dhomë këshillimi nga Kolegji, duke vendosur kalimin e saj në seancë gjyqësore. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. ***Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.***
- iii) Çështja me nr. 52111-00875-00-2011 akti, që i përket të pandehurit S.N, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 84,278/2 dhe 323/1 të Kodit Penal. Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit (faqe 794-810) rezulton se fashikulli i kësaj çështje nuk gjendet dhe gjatë procesit të rivlerësimit është administruar vetëm relacioni i nxjerrë nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve dhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. 00-2014-88, datë 23.01.2014. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. ***Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.***

Në gjashtë çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, nga aktet e dosjeve të administruara, rezulton si më poshtë:

- iv) Çështja me nr. 86000-00043-00-2014 akti, që i përket kërkuesit E.B, me objekt “Lirim para kohe me kusht”, sipas nenit 64 të Kodit Penal. Nga të dhënat e administruara në nuk rezulton të jetë administruar relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor. Në dosje administrohet vetëm vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka gjykuar çështjen në dhomë këshillimi në datë 16.01.2014. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. ***Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.***
- v) Çështja me nr. 86000-00402-00-2014 akti, që i përket kërkuesit T.Z, me objekt “Lirim me kusht”, sipas nenit 64 të Kodit Penal. Nga të dhënat e administruara në nuk rezulton të jetë administruar relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor. Në dosje administrohet vetëm vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka gjykuar çështjen në dhomë këshillimi në datë 03.04.2014. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. ***Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.***
- vi) Çështja me nr. 56180-01434-0-2013 akti, që i përket të pandehurve S.L dhe M.H, akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 278/2, 279 dhe 301 të Kodit Penal. Nga të dhënat e administruara rezulton të jetë administruar relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor por nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit apo datën e përfundimit të relacionit. Në dosje administrohet vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka gjykuar çështjen në dhomë këshillimi në

datë 14.07.2015. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. ***Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.***

vii) Çështja me nr. 53101-01334-00-2013 akti, që i përket të pandehurve A.H dhe S.B, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 134/2 të Kodit Penal. Nga të dhënat e administruara rezulton të jetë administruar relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor por nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit apo datën e përfundimit të relacionit. Në dosje administrohet vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Larte që ka gjykuar çështjen në dhomë këshillimi në datë 02.07.2015. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. ***Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.***

viii) Çështja me nr. 56430-00489-00-2014 akti, që i përket të pandehurës M.H, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 290/1 të Kodit Penal. Nga të dhënat e administruara rezulton të jetë administruar relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor por nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit apo datën e përfundimit të relacionit. Në dosje administrohet vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Larte që ka gjykuar çështjen në dhomë këshillimi në datë 13.10.2015. Nuk ka të dhëna për kohën e caktimit të çështjes ndihmësit ligjor ose për momentin e vënies së çështjes në lëvizje nga relatori. ***Për pasojë, koha e përgatitjes së relacionit nuk mund të përcaktohet.***

Në tërësi për 8 çështjet e analizuar<sup>52</sup>, në asnjë prej tyre nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të identifikuar kohën e përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor, pasi mungojnë edhe të dhënat për datën e dorëzimit të dosjes ndihmësmagjistrates me qëllim përgatitjen e relacionit si dhe kohën e vënies në lëvizje të dosjes nga gjyqtari relator nëpërmjet vendimit për caktimin e seancës. Për pasojë, përlllogaritja e kohës së mundshme të përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor është e pamundur dhe do të vlerësohet se ato janë përgatitur duke respektuar afatin e vënë nga gjyqtari relator, referuar kjo edhe vlerësimeve të Kolegjit për këtë aspekt.

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në mungesë të standardeve minimale kohore të miratuara brenda të cilave duhet të përgatitej dokumenti ligjor nga ndihmësmagjistrati në periudhën e vlerësimit si dhe në pamundësi të përlllogaritjes së kohës mesatare të përgatitjes së relacioneve për 8 çështjet e analizuar, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistrates në këtë tregues është shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 15 pikë.*

<sup>52</sup> Për gjyqtaren {...} janë analizuar çështjet për 8 dosje të përzgjedhura me short, ndërkohë që 3 dosje janë vendime gjyqësore të marra prej saj gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

## **2.B.B. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE TË PËRGATITUR PËR RELATIM**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna lidhur me këtë tregues.

Në aktin e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet, sikurse për treguesin e mësipërm, se : *”..E aftë për të përgatitur relacionet e çështjeve, brenda afateve kohore të përcaktuara nga gjyqtari pranë të cilit punon, bazuar edhe në kriteret e përcaktuara në rregulloren e gjykatës, dhe që i janë caktuar gjyqtarit nëpërmjet shortit elektronik.”*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, për pikëzimin e këtij treguesi përlllogaritet koha mesatare që i dedikohet përpunimit të dokumenteve ligjore për çdo çështje, krahasuar me standardet kohore të përcaktuara nga Mbledhja e Gjyqtarëve për çdo kategori çështjesh.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosje si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësi, për përlllogaritjen e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje sipas kategorive, evidentohen disa elementë që nuk mundësojnë përlllogaritjen e saj, si më poshtë:

- Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk rezultojnë standarde kohore të miratuara për përgatitjen e dokumentit ligjor nga ndihmësmagjistrati, për kategori çështjesh, dhe as për çështjet në tërësi;
- Të dhënat statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit nuk i diferencojnë çështjet në kategori dhe nuk përmbajnë informacion për kohën e hartimit të dokumentit ligjor;
- Të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për 8 çështjet e përzgjedhura me short nuk mundësojnë përlllogaritjen e kohës mesatare të përgatitjes së dokumentit ligjor për kategori çështjesh;
- Mungesë të dhënash për përlllogaritjen e përafërt të kohës së përgatitjes së dokumentit ligjor duke iu referuar kohës së vënies në lëvizje të çështjes nga gjyqtari realator deri në momentin e relatimit, pasi në dosjet gjyqësore të administruara nuk ka vendim për kalimin e çështjes në seancë në dhomë këshillimi.

Sa më sipër, duke konsideruar mungesën e të dhënave në raport me vlerësimin e kolegjit të kryer për ndihmësmagjistraten gjatë gjithë kohës së ushtrimit të detyrës, koha mesatare e përgatitjes së dokumentit ligjor për kategori çështjes është në pamundësi objektive të përlllogaritjet dhe për këtë arsye do të vlerësohet dhe pikëzohet në nivel maksimal.

## KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, në mungesë të standardeve minimale kohore të miratuara brenda të cilave duhet të përgatitej dokumenti ligjor nga ndihmësmagjistrati në periudhën e vlerësimit si dhe pamundësisë objektive të përlllogaritjes së kohës mesatare të përgatitjes së relacioneve për 8 çështjet e analizuara, aftësia e ndihmësmagjistrates në këtë tregues vlerësohet shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje të përgatitur për relativim” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 20 pikë.*

## **2.C. METODOLOGJIA E PUNËS**

### **2.C.A AFTËSIA PËR TË EVIDENTUAR E KRYER VEPRIMET E NEVOJSHME DHE SHMANGIEN E VEPRIMEVE JOPRODUKTIVE NË FUNKSION TË ORGANIZIMIT TË PROCESIT GJYQËSOR**

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit , sa i përket këtij treguesi, konkludohet se :”Nga të gjitha praktikatat e administruara, nuk ka dokumentimin të veprimeve të kryera nga ndihmësi ligjor, me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie. nga përmbajtja e 4 dokumenteve ligjore, relacione të ndihmësit ligjor, konstatohet se në çdo rast, ndihmësja ligjore ka studiuar çështjen gjyqësore e ka relatuar për çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, thelbin e analizës ligjore si dhe shkaqet e rekursit. Këto veprime ajo i ka materializuar në relacionin ligjor, ku ka plotësuar elementët proceduralë të kërkuar në nenin 21, të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në R. Sh” dhe nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr.214, datë 12.09.2014 të kryetarit të kësaj gjykate...”

Në aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : ”E aftë për të planifikuar përparësinë e çështjeve penale dhe radhën e shqyrtimit të çështjeve në dhomë këshillimi, sipas kriterëve të përcaktuara në urdhër nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet një metodologjie të qartë si dhe për të organizuar veprimet e nevojshme procedurale dhe administrative me stafin e administratës së gjykatës. E aftë për të përgatitur relacionet e çështjeve brenda afateve kohore të përcaktuara nga gjyqtari pranë të cilit punon, bazuar në kriteret e përcaktuara në rregulloren e gjykatës, dhe që i janë caktuar gjyqtarit nëpërmjet shortit elektronik. E aftë për të ndihmuar gjyqtarin në planifikimin e seancave gjyqësore, të dosjeve

*gjqësore që kanë kaluar për gjykim, duke dhënë edhe mendimin për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.<sup>53</sup>”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Nga 9 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim nuk rezultojnë të dhëna sa i përket ndihmës dhe kontributit të ndihmësit ligjor në drejtim të respektimit të rendit kronologjik të çështjeve për tu përgatitur në përputhje me afatet ligjore, respektimin e afateve të përcaktuara nga gjyqtari relator ose Kolegji, kryerjen e veprimeve efektive dhe në kohë në bashkëpunim me kryesekretarinë e gjykatës, planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore ose në dhomë këshillimi, kryerjen në kohë të njoftimeve/shpalljeve, dokumentimin e vendimeve ose veprimeve të tjera procedurale, ndjekjen e seancave apo diskutimeve për çështjet si dhe ndihmën në përgatitjen e vendimit në formën që u njoftohet palëve.

Në dosjet gjyqësore të cilat i përkasin çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nga 9 çështje, vetëm për 8<sup>54</sup> prej tyre administrohen dosjet e plota të Gjykatës së Lartë lidhur me çështjet. Nga këto 8 çështje të administruara, në (i) 4 prej tyre administrohet rekursi, relacioni i ndihmësit ligjor dhe vendimi i Kolegjit Penal (*nuk administrohen procesverbale dhe çështjet janë shqyrtuar në dhomë këshillimi*); (ii) në 2 dosje administrohet vetëm rekursi dhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë por mungon relacioni i ndihmësit ligjor<sup>55</sup> dhe (iii) në 2 çështje të cilat janë shqyrtuar në seancë, në dosje administrohen vendimi i Kolegjit Penal në dhomë këshillimi, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, relacioni i ndihmësit ligjor, procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, njoftimet për seancat, konkluzionet ose qëndrimet e palëve dhe vendimi i Kolegjit Penal në seancë gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim rezulton se çështjet e shqyrtuar në dhomë këshillimi kanë përfunduar në seancën e caktuar dhe njoftimet e palëve megjithëse nuk janë administruar në dosje, rezulton të jenë relatuar në relacionin e ndihmësit ligjor si të verifikuara. Për dy çështjet e shqyrtuara në seancë, rezulton që njoftimet e urdhëruar nga trupi gjykues në seancë gjyqësore, janë kryer dhe administruar në dosje. Nuk rezulton që ndonjë nga seancat gjyqësore të ketë dështuar për moskryerjen e njoftimeve efektive. Ky element në mënyrë të tërthortë tregon se ndihmësi ligjor ka kontribuar në mënyrë efektive për kryerjen e njoftimeve/shpalljeve në kohë dhe me efektivitet.

Në mungesë të të dhënave konkrete lidhur me aspektet që shërbejnë për vlerësimin dhe pikëzimin e treguesit të aftësisë për të evidentuar dhe kryer veprimet e nevojshme procedurale dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor, si dhe duke u bazuar në mendimin e Kolegjit Penal, i cili në të gjitha aktet e vlerësimit të ndihmësit

---

<sup>53</sup> Ky konkluzion është i njëjtë në të gjitha aktet e vlerësimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

<sup>54</sup> Gjashtë dosjet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit administrohen të plota ndërsa për 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura për efekt të rivlerësimit kalimtar, në dosjen e rivlerësimit administrohen dosjet e plota vetëm për dy prej tyre. Për një nga çështjet, çështja me nr. akti 52111-00875-00-2011 që i përket të pandehurit S.N, përfunduar me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-88, datë 23.01.2014, sipas praktikës së administruar në dosjen e rivlerësimit, fashikulli i Gjykatës së Lartë nuk gjendet dhe për efekt të procesit të vlerësimit është administruar vetëm kopja e relacionit nga sistemi elektronik dhe vendimi i Gjykatës së Lartë.

<sup>55</sup> Çështjet e përfunduara me vendimin nr. 00-2018-447, datë 03.04.2014 dhe vendimin nr. 00-2014-2, datë 16.01.2014.



ligjor, ka vlerësuar maksimalisht aftësitë e saj në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit, prezumohet se aftësitë e ndihmësmagjistratit në lidhje me këtë tregues janë shumë të larta.

## KONKLUSIONE

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi dhe mungesës së të dhënave konkrete lidhur me veprimet procedurale të kryera nga ndihmësi ligjor në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit në funksion të organizimit të procesit gjyqësor për çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, aftësitë e ndihmësmagjistrates për këtë tregues vlerësohen shumë të larta dhe pikëzohen maksimalisht.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin “aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

## **2.C.B AFTËSIA PËR TË EVIDENTUAR BRENDA ÇËSHTJEVE TË CAKTUARA PËR RELATIM, ATO QË KËRKOJNË VËMËNDJE TË POSACME DHE QË DUHET TË TRAJTOHEN ME PËRPARËSI, PËR SHKAK TË KËRKESAVE PROCEDURALE**

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna specifike lidhur me këtë tregues por për aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore, konkludohet siç është parashtruar në treguesin më sipër.

Në aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”E aftë për të planifikuar përparësinë e çështjeve penale dhe radhën e shqyrtimit të çështjeve në dhomë këshillimi, sipas kriterëve të përcaktuar me urdhër nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet një metodologjie të qartë si dhe për të organizuar veprimet e nevojshme procedurale dhe administrative me stafin e administratës së gjykatës,”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Nga 9 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezultojnë çështje të cilat duhet të trajtohen me përparësi për shkak të afatit ligjor të shqyrtimit. Në aktet e vlerësimit të kolegjit, sa i përket aftësive të ndihmësit ligjor lidhur me këtë tregues nuk ka të dhëna specifike, por aftësitë organizative në drejtim të metodologjisë dhe menaxhimit të kohës, janë vlerësuar maksimalisht.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit sa i përket aspekteve për vlerësimin dhe pikëzimin e treguesit të aftësisë për të evidentuar çështjet që kërkojnë vëmendje të posaçme, si dhe duke konsideruar vlerësimet e Kolegjit Penal i cili ka vlerësuar maksimalisht aftësitë e ndihmësit ligjor në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit, prezumohet se aftësitë e ndihmësmagjistrates në lidhje me këtë tregues janë shumë të larta.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi dhe vlerësimeve të Kolegjit, prezumohet se ndihmësi ligjor ka treguar aftësi shumë të larta në evidentimin dhe përgatitjen për relativitet të të gjitha çështjeve për të cilat ligji procedural ka parashikuar afate ligjore shqyrtimi. Për këtë arsye aftësitë e saj për këtë tregues vlerësohen shumë të larta dhe pikëzohen maksimalisht.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në treguesin "aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relativitet, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi, për shkak të kërkesave procedurale" është "shumë e lartë" dhe pikëzohet me 10 pikë.*

## **2.C.C. RREGULLSHMËRIA, SAKTËSIA E PLOTËSIA E DOSJES GJYQËSORE**

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të;
- Dokumentet ligjore dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :*"Në 2 nga 5 dokumentet e përzgjedhura me short, rezulton se mendimi i ndihmësit ligjor është përfshirë në dosjet fizike përkatëse, ndërsa dosja e tretë nuk na u vu në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me qëllim vëzhgimin e saj. Por, duhet theksuar se në asnjë prej dokumenteve të paraqitura nga subjekti dhe relacioneve të shortuara, nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre, pasi aktet nuk kanë datë dhe as nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit.."*

Në aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *"E aftë për të ndihmuar gjyqtarin në planifikimin e seancave gjyqësore, të dosjeve gjyqësore që kanë kaluar për gjykim, duke dhënë edhe mendimin për zgjidhjen përfundimtare të çështjes..."*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Për tre dosjet e përzgjedhura me short në kuadër të procedurës së rivlerësimit kalimtar, vetëm për 2 prej tyre është administruar në dosjen e rivlerësimit, fashikulli i plotë i Gjykatës së Lartë në

lidhje me çështjet konkrete ndërsa për 1 çështje, nga praktika dokumentare që administrohet në dosjen e rivlerësimit, rezulton se fashikulli nuk është vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë pasi nuk gjendjet.

Për gjashtë çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit, janë administruar fashikujt e plotë të çështjeve të cilat i përkasin dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim.

Në tërësi, nga 8 çështje të përzgjedhura me short për vlerësim, duke përjashtuar 1 çështje për të cilën fashikulli nuk është administruar pasi nuk gjendet, rezulton se :

- (i) në 2 prej tyre relacioni i ndihmësit ligjor nuk administrohet në dosje<sup>56</sup>;
- (ii) në 6 prej tyre, relacioni i ndihmësit ligjor administrohet në dosje<sup>57</sup>.

Aktet e 9 dosjeve të administruara janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin kronologjik, në varësi të rritit të shqyrtimit në dhomë këshillimi apo seancë gjyqësore. Në çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi në dosje administrohen (i) rekursi, (ii) relacioni i ndihmësit ligjor; (iii) vendimi i Kolegjit Penal. Në dosjet e shqyrtuara në seancë gjyqësore, dokumentacioni është renditur duke ndjekur përgjithësisht këtë rregull: (i) rekurs, (ii) relacion i ndihmësit ligjor, (iii) vendim i Kolegjit në dhomë këshillimi, (iv) parashtrimet ose konkluzionet e palëve, (v) procesverbalet e seancave dhe sipas rastet njoftimet e palëve sipas datave, (vi) vendim i Kolegjit në seancë gjyqësore.

Nuk evidentohet përfshirja në dosje e akteve që nuk i përkasin çështjes konkrete, por në 2 nga 8 dosjet e analizuara evidentohet mungese e relacionit të përgatitur nga ndihmësi ligjor.

Të gjitha dosjet e administruara paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të renditura në mënyrë kronologjike dhe mund të shfrytëzohen pa vështirësi.

## KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjes gjyqësore janë të rregullta dhe të sakta por jo në çdo rast janë të plota, pasi në 2 nga 8 çështjet e përzgjedhura me short, mungon dokumenti ligjor (relacioni) i përgatitur nga ndihmësi ligjor. Edhe në dosjet ku relacionet janë pjesë e tyre, ato nuk kanë firmën e ndihmësmagjistrates. Për këtë arsye, vlerësohet se shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në lidhje me këtë tregues është mbi mesataren.

Lidhur me parashtrimin e gjyqtarës se nuk ka qenë detyrë e ndihmësit ligjor, por detyrë e sekretarisë gjyqësore renditja, plotësia dhe saktësia e dokumentacionit të dosjes, në asnjë moment nuk është ngarkuar me përgjegjësi ndihmësi ligjor për renditjen e akteve të dosjes apo rregullsinë e tyre. Ajo çka rezulton nga dosjet e administruara është mungesa e vetë relacioneve

---

<sup>56</sup> Çështjet e përfunduara me vendimin nr. 00-2014-2, datë 16.01.2014 dhe vendimin nr. 00-2014-447, datë 03.04.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

<sup>57</sup> Në çështjen e përfunduar me vendimin nr. 00-2013-1599, datë 05.12.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në dosje administrohet relacioni i hartuar nga ndihmësi ligjor Ferdinand Caka, hartuar para vendimmarrjes së Kolegjit në dhomë këshillimi. Trupa gjyqësore që ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore është e ndryshme dhe në dosje nuk administrohen akte/relacion i hartuar nga ndihmësja ligjore {...} lidhur me zgjidhjen e çështjes në themel.

të përgatitura prej saj. Referuar Metodologjisë për këtë tregues është vlerësuar shkalla e kujdesit të treguar nga ndihmësmagjistratja jo vetëm për ruajtjen e renditjes së akteve të dosjes dhe të materialeve të tjera me qëllim që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme, por edhe shkalla e kujdesit e mbikëqyrja e procesit administrues të dokumentacionit në dosje, duke i dorëzuar aktet e përgatitura prej saj. Këto të fundit duhet të hartohen në formën e duhur të çdo akti procedural, ku nënshkrimi është element i domosdoshëm, pavarësisht ngarkimit të relacionit në sistemin ICCMIS.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit në lidhje me këtë tregues, vlerësohet mbi mesataren dhe pikëzohet me 8 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË NDIHMËSMAGJISTRATIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

**3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo ndihmësmagjistrat, pavarësisht institucionit ku kontribuon, është së pari gjyqtar dhe për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo ndihmësmagjistrat e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

**3.A. ETIKA NË PUNË**

Lidhur me këtë aspekt, në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “...Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...}. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative në këtë aspekt...”.

Në aktet e vlerësimit profesional të Kolegjit, lidhur me etikën në punë, konkludohet se: “Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjorë, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe kryetarin e gjykatës, si gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij. Respekton disiplinën në punë në përputhje me rregulloren e gjykatës dhe normat e etikës.”.

**3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD/KLGJ dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, sipas raportit analitik të rivlerësimit, rezulton se gjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj saj janë paraqitur 3 ankesa të cilat janë arkivuar pasi 2 prej tyre përmbanin pretendime të cilat zgjidhen nëpërmjet mjeteve të ankimit ndërsa 1 ankese përmban pretendime të përgjithshme dhe është arkivuar si e paplotë. Nga verifikimi i materialeve arkivore për trajtimin e tre ankesave, nuk rezultuan të dhëna të cilat mund të konsiderohen në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale apo etikës së gjyqtares.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale nr. 6081/7 prot., datë 15.10.2020, nga të dhënat arkivore të KLD/KLGJ, referohen tre ankesa të paraqitura në Inspektoratin e KLD-së lidhur me gjyqtaren {...}. Referuar të dhënave që rezultojnë nga dokumentet e marra nga arkiva e KLGJ-së sa i përket trajtimit të ankesave, siç përshkruhet më lart<sup>58</sup> në projekt raportin e vlerësimit, rezulton se :

(i) Ankesa e shtetasit M.S lidhet me pretendime lidhur me përmbajtjen e vendimit gjyqësor dhe pasqyrimin e mbrojtësit të palës ndërgjyqëse në vendim. Kjo ankesë është trajtuar dhe arkivuar nga Inspektorati i KLD-së me arsyetimin se nuk referohen të dhëna konkrete për veprimtarinë apo vendime gjyqësore të gjyqtares {...}. Nga përmbajtja e materialeve të trajtimit të saj nuk rezultojnë pretendime dhe as konstatime lidhur me elementë të vlerësimit të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtares.

(ii) Ankesa e shtetasit A.L lidhet me vendimin civil nr. 2063, datë 26.09.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kjo ankesë është trajtuar dhe arkivuar nga Inspektorati i KLD-së me arsyetimin se pretendimet e ankuesit lidhen me themelin e çështjes dhe janë objekt i trajtimit nga gjykatat më të larta. Nga përmbajtja e materialeve të trajtimit të saj nuk rezultojnë pretendime dhe as konstatime lidhur me elementë të vlerësimit të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtares.

(iii) Ankesa e shtetasit G.Sh, drejtues i Prokurorisë së Rrethit Shkodër, lidhet me vendimin penal nr. 111, datë 01.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kjo ankesë është trajtuar dhe arkivuar nga Inspektorati i KLD-së me arsyetimin se pretendimet e ankuesit lidhen me themelin e çështjes dhe janë objekt i trajtimit nga gjykatat më të larta. Nga përmbajtja e materialeve të trajtimit të saj nuk rezultojnë pretendime dhe as konstatime lidhur me elementë të vlerësimit të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtares.

Referuar materialit për trajtimin e çështjeve të referuara nga KPK, përcjellë nga ILD me shkresën nr. 3702/1 prot., datë 13.10.2021 dhe vendimit nr. 2137/6 prot., datë 13.10.2021, rezulton se janë trajtuar rastet dhe pavarësisht se asnjëri prej tyre nuk i përket periudhës së

---

<sup>58</sup> Shih faqen 10-14 të projektraportit.

vlerësimit 2013-2016, nuk evidentohet asnjë element që mund të ndikojnë në vlerësimin e këtij treguesi.

Nga tërësia e akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në proces, mungesë vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e znj. {...} gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës së ndihmës ligjore në Gjykatën e Lartë dhe detyrës së gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja {...}, gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmës ligjore në Gjykatën e Lartë, ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezultojnë asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezultojnë se ndihmësmagjistratja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

### ***Shkalla e etikës në punë të ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së ndihmësmagjistratit në lidhje me treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

## **3.B. INTEGRITETI**

Lidhur me këtë aspekt, në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna lidhur me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.”

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të Kolegjit nuk ka të dhëna apo vlerësim të drejtpërdrejtë sa i përket aspektit të integritetit.

### **3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të ndihmës ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD/KLGJ dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Nga të dhënat arkivore të KLD/KLGJ rezulton të jenë paraqitur dhe trajtuar tre ankesa, referuar dhe analizuar në treguesin më sipër, të cilat janë verifikuar nga Inspektorati i KLD dhe janë arkivuar me arsyetimin se (i) nuk përmbajnë të dhëna konkrete për verifikim pasi pretendimet janë të përgjithshme dhe ankesa është e paplotë dhe (ii) pretendimet e ankuesve lidhen me bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, pretendime të cilat zgjidhen nëpërmjet mjeteve të ankimit në gjykatat më të larta, duke mos u konstatuar asnjë e dhënë për shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: “...“12.8 Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë. 12.9 Komisioni, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën pamjaftueshmërisë në shumën 684.900 lekë, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij. Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë. 12.10 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016....”.

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sa i përket vlerësimit të figurës dhe aftësive profesionale, konkludohet se: “... Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.....Si konkluzion, Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, është “e aftë” pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçiente në masë të pranueshme. ....Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme: a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar kushtet në lidhje me tri kriteret e rivlerësimit për t’u konfirmuar në detyrë, Komisioni çmon se tri çështjet e analizuara më sipër, (1) nr. \*\*\*, regjistruar më 30.4.2010; (2) nr. \*\*\*, regjistruar më 15.10.2010; (3) nr. \*\*\*,

regjistruar më 8.11.2017, t'i transferohen organit kompetent për inspektim sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016..”.

Referuar materialit për trajtimin e çështjeve të referuara nga KPK, përcjellë nga ILD me shkresën nr. 3702/1 prot., datë 13.10.2021 dhe vendimit nr. 2137/6 prot., datë 13.10.2021, rezulton se janë trajtuar rastet dhe pavarësisht se asnjëri prej tyre nuk i përket periudhës së vlerësimit 2013-2016, nuk evidentohet asnjë element që mund të ndikojnë në vlerësimin e këtij treguesi.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të ndihmësmagjistrates.

## **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e ndihmësmagjistrates.

### ***Shkalla e integritetit të ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:***

*Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të ndihmësmagjistrates në lidhje me treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

## **3.C PAANËSIA**

Lidhur me këtë aspekt në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se: “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.”.

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka të dhëna për këtë aspekt.

### **3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);



***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Në dokumentet ligjore të dorëzuara nga ndihmësmagjistratja dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese në përmbajtje të dokumenteve ligjore (relacione) të saj.

Po ashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese në komunikimin me kolegët, administratën gjyqësore, gjyqtarët apo subjekte të tjera.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga ndihmësmagjistratja.

**KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ndihmësmagjistratja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, aftësia e ndihmësmagjistrates në lidhje me treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

**3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE PËR HEQJE DORË TË REFUZUARA NGA KRYETARI**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat statistikore;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;

Në raportin analitik të rivlerësimit dhe aktet për vlerësimin e aftësive profesionale të ndihmësmagjistratit nga Kolegji nuk ka të dhëna për numrin e kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga kryetari, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (9 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 1 dokument ligjor të përzgjedhur nga ndihmësmagjistratja) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për heqjen dorë nga trajtimi i çështjes.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, pavarësisht funksionit që ai ushtron përkohësisht si i komanduar, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin dhe aktet e Skemës së Vlerësimit të dala në bazë të këtij ligji, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave për heqje dorë të pranuar nga kryetari, për ndihmësmagjistraten {...} është i pa konsiderueshëm.

## KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari në periudhën e vlerësimit. Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari, vlerësohet si i pa konsiderueshëm.

### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:***

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave për heqje dorë të refuzuara nga Kryetari” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet “i pa konsiderueshëm”.*

### ***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”***

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

## 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i ndihmësmagjistratit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

### 4.A. AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

#### 4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e saj. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar në ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtarës dhe as kërkesa të vetë gjyqtarës për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.”.*

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, nuk ka të dhëna specifike në lidhje me këtë tregues por në treguesit e kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional, theksohet se: *“Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjorë, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe kryetarin e gjykatës, si gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij. Respekton disiplinën në punë në përputhje me rregulloren e gjykatës dhe normat e etikës.”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar 9<sup>59</sup> dokumenteve ligjore të hartuara nga ndihmësmagjistratja, rezulton se ajo është shprehur në mënyrë të qartë, transparente, të saktë, koncize dhe drejtpërdrejtë, duke respektuar normat e shkrimit ligjor.

Nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me mungesën e komunikimit të qartë dhe transparent të saj gjatë ushtrimit të funksionit të ndihmësit ligjor në komunikimin verbal me subjektet me të cilët ka bashkëpunuar apo me të tretët.

---

<sup>59</sup> Një nga dokumentet ligjore të administruara në dosjen e rivlerësimit kalimtar nuk është hartuar nga subjekti pasi mban emrin e ndihmësit ligjor Ferdinand Caka.

## KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka komunikim të qartë dhe transparent në komunikimin verbal si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj.

### *Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi*

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në lidhje me treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.*

## 4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit dhe aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji nuk ka të dhëna specifike lidhur me këtë tregues.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Referuar 1 dokument ligjor të përzgjedhur për vlerësim dhe akteve të 9 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve dhe pjesëmarrësve në proces.

Referuar burimeve të tjera të vlerësimit dhe në tërësi akteve të dosjes së vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna të cilat mund të krijojnë dyshim për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve apo pjesëmarrësve në proces, nga ana e ndihmëses ligjore.

## KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se ndihmësmagjistratja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

*Respektimi i konfidencialitetit nga ndihmësmagjistrati dhe pikëzimi*

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në lidhje me treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR**

Lidhur me aftësinë për të bashkëpunuar në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “Në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse, nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtarin e Gjykatës së pranë së cilit ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor apo me trupën gjyquese të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Po kështu nuk janë konstatuar vonesa në relatimin e çështjes, që të ketë sjellë problematikë në gjykimin e çështjes nga ana e Kolegjit, kjo edhe për faktin se praktika e punës në këtë gjykatë dhe veprimet e ndihmësit ligjor me dosjet përkatëse nuk evidentohen në regjistra, për të matur parametrat e shpejtësisë dhe të sasisë së punës. Gjithashtu, në 2 dokumentet ligjore dhe në 2 dosjet e vëzhguara për periudhën si gjyqtare, nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në katër rastet e çështjeve si gjyqtare subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore, për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile..”.

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, nuk ka të dhëna specifike në lidhje me këtë tregues por në treguesit e kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional, theksohet se :”Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjore, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe Kryetarin e Gjykatës së Lartë, gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij..”.

#### **4.B.A. GATISHMËRIA DHE SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj ndihmësmagjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, janë edhe vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të ndihmësmagjistrates me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Në aktet e vlerësimit profesional të ndihmësit ligjor nga Kolegji, aftësia e saj për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer njohuritë dhe përvojën profesionale me kolegët vlerësohet në nivel shumë të lartë.

Sa më sipër, në mungesë të të dhënave, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, për mungesën e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ka ekzistuar dhe ka qenë në nivel të lartë.

## KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të ndihmësmagjistrates me kolegët, vlerësohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të bashkëpunimit dhe ndërveprimit me ta.

### *Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi*

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në lidhje me treguesin “gatishmëria dhe shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

## 4.B.B GATISHMËRIA DHE KONTRIBUTI PËR TË KRYER DETYRA TË TJERA QË I NGARKOHEN NGA ORGANET DREJTUESE TË GJYKATËS

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, përveçidentimit të numrit të çështjeve të përgatitura dhe relatuara nga ndihmësi ligjor, evidentohet edhe kontributi i saj në përgatitjen e projektvendimeve gjyqësore penale, duke u evidentuar në këto akte<sup>60</sup>, të dhënat si më: “..Për vitin 2012 ka relatuar 37 dosje penale, në vitin 2013 ka relatuar në total 285 çështje penale, nga të cilat 242 kanë përfunduar me mospranim të rekursit dhe 43 kalim për shqyrtim në seancë gjyqësore si dhe ka përgatitur 71 projektvendime gjyqësore penale...”, “..Për vitin 2014 ka relatuar në total 115 çështje penale, si dhe ka përgatitur 40 projektvendime gjyqësore penale, pasi nga muaji maj –dhjetor 2014 ka qenë me leje lindje.”, “...Për periudhën janar 2015- korrik 2015 ka relatuar në total 154 dosje penale si dhe ka përgatitur 13 projektvendime gjyqësore penale.”, “Për periudhën gusht – 15 nëntor 2015 ka relatuar në total 53 dosje penale si dhe ka përgatitur 7 projektvendime gjyqësore penale, duke përfshirë dhe një vendim unifikues penal dhe një vendim të kolegeve të Bashkuara.”.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;

<sup>60</sup> Akt i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 331, datë 31.07.2015 për periudhën e vlerësimit 15 nëntor 2012-31 dhjetor 2012, janar 2013- dhjetor 2013; Akt i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 332, datë 31.07.2015 për periudhën e vlerësimit janar 2014- dhjetor 2014; Akt i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 333, datë 31.07.2015 për periudhën e vlerësimit janar 2015- korrik 2015; Akt i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 14, datë 26.02.2016 për periudhën e vlerësimit gusht – 15 nëntor 2015;

- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji.

### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), një nga te burimet e vlerësimit për këtë tregues mungon ndërsa mendimi i kryetarit është pjesë e aktit të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë tregues do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e tjera të vlerësimit.

Referuar akteve të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji, rezulton se aftësia e ndihmëses ligjore {...} për të kontribuar në kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara nga organet drejtuese të gjykatës është vlerësuar e lartë, duke renditur edhe detyrat e kryera në këtë drejtim. Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë aspekt, konkludohet se : *“.....Në datën 16 prill 2015 ka marrë pjesë në organizimin e tryezës së rrumbullakët me temë “Gjykimi penal dhe unifikimi i praktikës gjyqësore” të realizuar nga Gjykata e Lartë me mbështetjen e fondacionit Hanns Siedel, në rolin e koordinatorës në përfundim të të cilit ka përgatitur raporte të cilat i janë dërguar Kuvendit të Shqipërisë, Gjykatës Kushtetuese, Shkollës së Magjistraturës, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Misionit Euralius, dhe fondacionit Hanns Siedel, me propozime konkrete të pjesëmarrësve për unifikimin e praktikës dhe ndryshime ligjore. Në këtë tryezë gjithashtu ndihmësja ligjore {...} ka referuar një temë për pjesëmarrësit. Në datat 25.06.2015-26.06.2015 ka marrë pjesë në organizimin e tryezës së rrumbullakët me temë “Gjykimi civil, penal dhe administrativ dhe unifikimi i praktikës gjyqësore”, të organizuar nga Gjykata e Lartë me mbështetjen e fondacionit Hanns Siedel, në rolin e bashkë koordinatorës, në përfundim të të cilit ka përgatitur raporte me mendimet e pjesëmarrësve, ndihmës ligjore të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore dhe ndryshime ligjore. Në këtë tryezë ndihmësja ligjore {...} ka koordinuar pjesën që i përket gjykimit penal.<sup>61</sup>”.*

Në kushtet kur rezulton angazhimi i ndihmësmagjistrates në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga organet drejtuese të gjykatës, veç kontributit të saj në lidhje me trajtimin e çështjeve gjyqësore dhe kryerjen e detyrave thelbësore të ndihmësit ligjor, vlerësohet se aftësia e saj për këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e ndihmësmagjistrates në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga organet drejtuese të gjykatës, aftësia e saj në lidhje me këtë tregues pikëzohet maksimalisht.

***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

<sup>61</sup> Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 333 prot., datë 31.07.2015 për periudhën janar 2015- korrik 2015.



*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates për këtë tregues, duke qenë se rezulton angazhimi dhe kontributi i saj konkret, pikëzohet me 5 pikë.*

#### **4.B.C AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR DHE PËR TË REAGUAR ME EFIKASITET NË RAST NEVOJE**

Në raportin analitik të rivlerësimit dhe aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji nuk ka të dhëna specifike lidhur me këtë tregues, por evidentohen dhe vlerësohen maksimalisht aftësitë e komunikimit dhe bashkëpunimit të ndihmës ligjore, duke theksuar se :”Korrekte në marrëdhënie me kolegët ndihmës ligjore, administratën e gjykatës, me të cilët është bashkëpunuese, me gjyqtarët dhe Kryetarin e Gjykatës së Lartë, gjatë orarit zyrtar ashtu edhe jashtë tij..”.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Akti i vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë vetëvlerësimi i ndihmësmagjistratit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) një nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungon ndërsa mendimi i kryetarit është pjesë e aktit të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë tregues do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe të dhënave që rezultojnë nga burimet e tjera të vlerësimit.

Referuar akteve të vlerësimit të aftësive profesionale nga Kolegji, rezulton se aftësia e ndihmës ligjore {...} për të krijuar marrëdhënie korrekte me gjyqtarët, kancelarin dhe administratën gjyqësore si dhe aftësia e saj për të shmangur situata konfliktuale është vlerësuar shumë e lartë.

Referuar burimeve të vlerësimit dhe tërësisë së akteve të dosjes së vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për ekzistencën e situatave të konfliktit apo mënyrës së menaxhimit të tyre, raste të shfaqjes së problemeve apo vështirësive gjatë punës dhe reagimi i saj për zgjidhjen e tyre me efikasitet dhe duke ruajtur qetësinë dhe etikën.

Në kushtet kur nuk ka të dhëna konkrete që mund të cenojnë vlerësimin për aftësinë e ndihmësmagjistratit për të bashkëpunuar dhe reaguar me efikasitet në rast nevojë dhe në të njëjtën kohë, shkalla e bashkëpunimit dhe ndërveprimit të saj me administratën gjyqësore është vlerësuar maksimalisht nga Kolegji, vlerësoj se aftësia e saj për këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues vlerësohet se shkalla e bashkëpunimit dhe aftësia për të reaguar me efikasitet në rast nevojë për ndihmësmagjistratën {...} është shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.



### ***Shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së ndihmësmagjistrates në lidhje me këtë tregues vlerësohet shumë e lartë dhe pikëzohet me 10 pikë.*

## **4.C GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA**

Lidhur me këtë aspekt në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “...Subjekti i rivlerësimit {...}, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimit programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ajo ka marrë pjesë në 13 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 27 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve ku ajo ka marrë pjesë ka lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile dhe penale. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë pjesë edhe në 4 aktivitete të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, në 7 ditë gjithsej.”.

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji, lidhur me këtë aspekt, konkludohet se :”Ka marrë dhe merr pjesë aktive të aktivitetet profesionale dhe trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, që janë pjesë e trajnimit vazhdues. Ka marrë pjesë në trajnimin profesional 10 ditor të organizuar nga Asser Instituut, Hagë, Holandë, në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë dhe Ambasadën Holandeze në Shqipëri, në temën “Enhancing Efficiency in dhe Administration of Justice” ( Rritja e efikasitetit në administrimin e drejtësisë), në datat 6-16 tetor 2013<sup>62</sup>.”; “Ka marrë dhe merr pjesë aktive të aktivitetet profesionale dhe trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, që janë pjesë e trajnimit vazhdues<sup>63</sup>.”; “Ka marrë dhe merr pjesë aktive të aktivitetet profesionale dhe trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, që janë pjesë e trajnimit vazhdues. Ka marrë pjesë në trajnimin profesional 10 ditor të organizuar nga Asser Instituut, Hagë, Holandë, në temën “Access to Justice” (Aksesi në drejtësi), në datat 15-25 mars 2015. Në datën 16 prill 2015 ka marrë pjesë në organizimin e tryezës së rrumbullakët me temë “Gjykimi penal dhe unifikimi i praktikës gjyqësore” të realizuar nga Gjykata e Lartë me mbështetjen e fondacionit Hanns Siedel, në rolin e koordinatorës në përfundim të të cilit ka përgatitur raporte të cilat i janë dërguar Kuvendit të Shqipërisë, Gjykatës Kushtetuese, Shkollës së Magjistraturës, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Misionit Euralius, dhe fondacionit Hanns Siedel, me propozime konkrete të pjesëmarrësve për unifikimin e praktikës dhe ndryshime ligjore. Në këtë tryezë gjithashtu ndihmësja ligjore {...} ka referuar një temë për pjesëmarrësit. Në datat 25.06.2015-26.06.2015 ka marrë pjesë në organizimin e tryezës së rrumbullakët me temë “Gjykimi civil, penal dhe administrativ dhe unifikimi i praktikës gjyqësore”, të organizuar nga Gjykata e Lartë me mbështetjen e fondacionit Hanns Siedel, në rolin e bashkë koordinatorës, në përfundim të të cilit ka përgatitur raporte me mendimet e pjesëmarrësve, ndihmës ligjore të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore dhe ndryshime ligjore. Në këtë tryezë ndihmësja ligjore {...} ka koordinuar pjesën që i

<sup>62</sup> Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 331 prot., datë 31.07.2015 për periudhën janar 2013- dhjetor 2013.

<sup>63</sup> Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 332 prot., datë 31.07.2015 për periudhën janar 2014- dhjetor 2014.

*përket gjykimit penal.<sup>64</sup>”, “Ka marrë dhe merr pjesë aktive të aktivitetet profesionale dhe trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, që janë pjesë e trajnimit vazhdues.<sup>65</sup>”.*

#### **4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Referuar raportit analitik të rivlerësimit rezulton se gjyqtarja {...}, ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) në cilësinë e pjesëmarrësit, në 13 aktivitete trajnuese, pjesë e Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjithsej 23 ditë trajnimi<sup>66</sup>;
- (ii) në cilësinë e pjesëmarrësit në aktivitete trajnuese jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë :
  - Trajnim me temë “Nxitja e efencës në administrimin e drejtësisë”, me pjesëmarrjen e këshilltarëve ligjorë në Gjykatën e Lartë, organizuar nga Gjykata e Lartë në bashkëpunim me ambasadën holandeze, në Hagë, Holandë, në datat 6-16 tetor 2013 (10 ditë);
  - Trajnim me temë “Aksesi në drejtësi”, organizuar në kuadër të programit Matra Patrol, nga ASSER Institute, Hage, Holandë, në datat 5-15 mars 2015 (10 ditë);

Gjithsej ka marrë pjesë në dy trajnime 10 ditore jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat kanë zgjatur në total **20 ditë**.

Sa më sipër, rezulton se znj. {...}, ka marrë pjesë në 15 aktivitete të formimit profesional të llojit trajnime dhe konferenca, brenda dhe jashtë programit të Formimit Vazhdues, të cilat kanë zgjatur në **total 43 ditë**. Dy nga këto programe trajnimi, të zhvilluara jashtë programit të trajnimit vazhdues të Sh.M, vlerësohen si programe afatshkurtra të formimit profesional, të specializuara në një fushë të caktuar të së drejtës, të cilat sipas Metodologjisë së Pikëzimit, konsiderohen vlerë e shtuar në lidhje me aftësitë e ndihmësmagjistratit për këtë tregues.

#### **KONKLUZIONE**

---

<sup>64</sup> Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 333 prot., datë 31.07.2015 për periudhën janar 2015- korrik 2015.

<sup>65</sup> Akti i vlerësimit të ndihmësit ligjor nr. 14 prot., datë 26.02.2016 për periudhën e vlerësimit gusht – 15 nëntor 2015.

<sup>66</sup> Sipas të dhënave të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton të jetë angazhuar në cilësinë e lehtësuesit në aktivitetin trajnues të zhvilluar në datat 29 dhe 30 maj 2012, i cili duke qënë jashtë periudhës së vlerësimit 2013-2016, nuk konsiderohet në vlerësim.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja ka marrë pjesë në 15 aktivitete trajnuese, brenda programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë tij, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 43 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve ligjorë sipas parashikimeve të nenit 5, pika 3<sup>67</sup>, të ligjit nr.96/2015 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ndër të cilat 2 programe trajnimi afatshkurtra në fusha të ndryshme të drejtës.

***Pjesëmarrja e ndihmësmagjistratit në trajnime dhe pikëzimi:***

*Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e ndihmësmagjistrates në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është më shumë se 15/ditë dhe më pak se 120 ditë në 3 vite dhe pikëzohet me 20 pikë.*

#### **4.C.B. DISPONUESHMËRIA E NDIHMËSMAGJISTRATIT PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, rezulton se znj. {...} ka marrë pjesë në cilësinë e lehtësuesit në aktivitetin trajnues me temë “Kontrata e sigurimit të pasurisë dhe të jetës...”, të zhvilluar në datat 29 dhe 30 maj 2012. Ky angazhim është jashtë periudhës së vlerësimit që përfshin vitet 2013-2016, dhe për pasojë nuk mund të konsiderohet për efekt të këtij vlerësimi.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, të gjithë ndihmësmagjistratët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për ndihmësmagjistraten {...}, duke qenë nuk se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e ekspertit/lehtësuesit në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese.

---

<sup>67</sup> Në nenin 5, pika 3 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se :” 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.”.

***Disponueshmëria e ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi:***

*Referuar sa më sipër, për treguesin “disponueshmëria e ndihmësmagjistratit për trajnimin e gjyqtareve”, ndihmësmagjistratja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.*

**4.C.C PJESËMARRJA NË VEPRIMTARI NDËRINSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, vërtetimit me nr. 24/10 prot., datë 24.10.2016 të Gjykatës së Lartë dhe formularit të vetë deklarimit për aftësitë profesionale së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se znj. {...}, në periudhën e vlerësimit që përfshin vitet e plota 2013-2016, ka marrë pjesë në disa aktivitete, të cilat vlerësohen si veprimtari ndërinstitucionale, që kanë pasur si qëllim shkëmbimin e eksperiencave në fusha të ndryshme të së drejtës, si më poshtë:

(iii) Tryezë e rumbullakët me temë “Gjykimi penal dhe unifikimi i praktikës gjyqësore”, organizuar nga Gjykata e Lartë, në datë 16.04.2015<sup>68</sup>.

(iv) Tryezë e rumbullakët me temë “Evidentimi i nevojave për unifikim të praktikës gjyqësore”, organizuar nga Gjykata e Lartë, në datë 26 dhe 27 qershor 2015, me pjesëmarrjen e ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë<sup>69</sup>.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të ndihmësmagjistratit, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për ndihmësmagjistraten {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë duke qenë se rezultoi angazhimi i saj në veprimtari të kësaj natyre.

**KONKLUZIONE**

<sup>68</sup> Pjesëmarrja në këtë aktivitet në rolin e koordinatores vërtetohet nga shkresa me nr. 24/10 prot, datë 24.10.2016 e kryetarit të Gjykatës së Lartë.

<sup>69</sup> Pjesëmarrja në këtë aktivitet në rolin e koordinatores vërtetohet nga shkresa me nr. 24/10 prot, datë 24.10.2016 e kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se ndihmësmagjistratja është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.

***Pjesëmarrja, kontributi i ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

*Referuar sa më sipër, për treguesin “angazhimi i ndihmësmagjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë” ndihmësmagjistratja pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezulton angazhimi i saj në disa aktivitete të kësaj natyre.*

#### **4.C.Ç PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të ndihmësit ligjor nga Kolegji;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Sipas formularit të vetë deklaramit<sup>70</sup> për aftësitë profesionale dhe akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe dosjen personale të gjyqtarit, rezulton në vitin 2014 ajo ka botuar, në bashkautorësi, librin me titull “Standardet e gjykimit civil, administrativ dhe penal përmes vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, 2000-2014”, botim i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë me mbështetjen e fondacionit Hanns Siedel, me ISBN 978-9928-4054-5-6, botimet “Afrojditi”, në të cilën ajo referon se ka punuar pjesën e vendimeve unifikuese në fushën penale.

Në formularin e vetëvlerësimit, dosjen e rivlerësimit dhe dosjen personale të gjyqtarës gjendet një shkrim tjetër i botuar në revistën “Jeta Juridike”, por nuk i përket periudhës së vlerësimit 2013-2016<sup>71</sup>.

#### **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për znj. {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë për shkak se rezultojnë të dhëna për publikime ligjore akademike gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016.

***Angazhimi i ndihmësmagjistratit dhe pikëzimi***

<sup>70</sup>Formulari i vetëdeklarimit, faqe 11 e në vijim e dosjes së rivlerësimit si dhe kopje e publikimeve dhe dokumenteve bashkëlidhur formularit.

<sup>71</sup> Shkrimi ligjor me temë “Mbi kontratën e sigurimit të jetës”, botuar në revistën shkencore Jeta Juridike, në muajin janar 2012.

*Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “publikime ligjore akademike” rezulton angazhimi i ndihmësmagjistrates dhe për këtë ky tregues pikëzohet me 5 pikë.*

***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”***

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të ndihmësmagjistratit	95	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të ndihmësmagjistratit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	98	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm